

# FORMULARI A2

## Ja degët ku rriten pikët e pranimit në universitetet publike

Pas rishikimit të kuotave nga Qeveria, rritet gara mes maturantëve ▶ F9



# FULLANI

## ISH-GVERNATORI NEN AKUZE PER "DAJTIN", ZBARDHEN 5 SHKELJET

Prokuroria i paraqet 5 akuzat. Fullani deklaron pajfjësi ▶ F10

# [SHQIPTARJA.com]

Lexoni  
Dëgjoni  
Shikoni

EDICIONI MULTIMEDIAL

Kjo gazetë përdor teknologjinë QR-CODE

ÇMIMI 30 LEKË | VITI V - NR.177 | E MËRKURË, 29-07-2015 | www.shqiptarja.com

# ANALIZA E VOTAVE



## KRYETARET NE RRETHE TE PS E PD QE RREZIKOJNE

Si ndryshojnë votat e marra nga opozita dhe maxhoranca në vitin 2011 dhe 2015

Tabelat e plota për qytetet në garkun Tiranë, Fier dhe Durrës. Udhëzimet e Ramës dhe Bashës

▶ FAQE 2-3



## TURKU TENTON TE VRAS POLICEN, I KERKON BASHKEJETESE

Përplasja pas ndërprerjes së lidhjes. Dëshmia në gjykatë: O bashkëjeto me mua ose do të vras fëmijët'

▶ FAQE 12

## Publikohen emrat që kanë marrë pronat në Tiranë

Listat e plota të AKKP për sipërfaqen e kthyer dhe objektet që u janë dhënë pronarëve

▶ FAQE 6-7

**DOSSIER**

## Në Berat me mitroloz në dorë, kontrolluam dhe brekët e grave

Zbulohen dokumentet nga dëshmia e Xhelal Staraveckës **F15**

**BMC Blue Medical Center**

Vizita, Analiza & Diagnostikim  
Të garantuara sipas protokolleve të mjekësisë bashkëkohore nga Blue Medical Center

**Të parandalosh, më mirë se të kurosh!**

Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë  
Tel: + 355 4 2370 668

Cel: +355 66 20 90 008  
Email: info@bmc.al, www.bmc.al

# "Analiza", shifrat e PD-së ku ka humbur dhe fituar

## "Si ka ndryshuar vota për Partinë Demokratike nga 2011-a"

LEONARD QUKU  
TIRANË



Shqiptarja.com zbardh sot shifrat krahasuese të rezultateve të Partisë Demokratike në zgjedhjet vendore të 2011-ës dhe 2015-ës, për bashkitë në tre qarqe të mëdha, Tiranë, Durrës dhe Fier. Sipas udhëzimit të kryetarit të PD, Lulzim Basha, shpërndarë degëve lokale 3 javë më parë, secila prej tyre duhet të dorë-

zonte në selinë blu rezultatet e 3 zgjedhjeve të fundit, vendore dhe parlamentare, për kandidatët dhe këshilltarët. Kjo do t'i shërbejë një procesi të thellë analize në PD, ku do të krahasohet rezultati i çdo qendre votimi. Në bazë të asaj që lexohet në grafikët krahasues të dy zgjedhjeve vendore, 2011 dhe 2015-ë, në votën për këshillin, diferencën më të thellë Partia Demokratike e ka në Bashkinë e Tiranës. Në votat për Këshillin Bashkiak, në krahasim me 4 vite më parë, PD ka humbur 8 mijë vota. Por, kjo diferencë është shumë herë me vogël se vota për kandidatën, mes Erion Veliajt dhe Halim Kosovës, ku kandidati socialist u shpall fitues me 43 mijë vota më

### TKURRJA

"PD ka rënë ndjeshëm, në krahasim me 4 vite më parë, në të 11 njësitë bashkiake të Tiranës. Në 13 komunat që iu bashkuan Tiranës, PD në votën për këshillin ka arritur të fitojë vetëm në dy".

shumë. PD ka një rënie të lehtë në Bashkinë e Vorës. Ndërsa në Kamëz, Lushnjë, Divjakë, Shijak, Krujë dhe Kavajë, krahasuar me 4 vite më parë.

### TIRANË

Diferenca në Tiranë krahasuar me 2011-ën, në votat

### RRITJA

"Edhe pse PD ka një rënie të lehtë në Bashkinë e Vorës, ajo ka një rritje të ndjeshme në Kamëz, Lushnjë, Divjakë, Shijak, Krujë dhe Kavajë, krahasuar me 4 vjet më parë".

për këshillin bashkiak, është 8 mijë vota më pak për PD-në. Në të 11-të njësitë bashkiake të Tiranës, PD është në rënie krahasuar me 4 vite më parë. Gjithsesi, diferenca e votave të këshillit, është disa herë më e vogël se shifra e përballjeve të kandidatëve Veliajt dhe Kosova. Sa i takon votave të 13 komunave që iu bashkuan Tiranës me ndarjen e re administrative, PD ka fituar vetëm në Dajt dhe në Pezë.



Durrës PD ka qenë shumë pranë ruajtjes së ekuilibrave të votave për këshillin, në krahasim me 2011-ën. Në Bashkinë e re të Durrësit, PD ka marrë për këshillin e bashkisë 25 439 vota, ose 400 vota më pak se në 2011-ën.

**FIER**  
Edhe vota e Fierit për këshillin bashkiak nuk korrespondon me diferencën e asaj për kryetarin. PD ka marrë 11 534 vota për këshillin bashkiak, ose e thënë ndryshe, 461 vota më pak se në 2011-ën. Ndryshe, Armando Sushabi fitoi me mbi 10 mijë vota përballë Enkelejd Alibeajt.

### PD/ QARKU TIRANE 2011-2015

	2011	%	2015	%
<b>Kavajë</b>	3,351	29.89%	4,023	28.81%
Komuna Helmes	606	33.69%	434	24.37%
Komuna Golem-Kavaje	871	20.37%	988	22.43%
Komuna Synej	983	34.38%	879	29.98%
Komuna Luz i Vogel	822	30.10%	789	28.63%
<b>6,633</b>	<b>29.50%</b>	<b>7,113</b>	<b>27.42%</b>	

	2011	%	2015	%
<b>Rrogzhinë</b>	636	16.58%	584	14.81%
Komuna Kryevidh	791	27.47%	662	24.43%
Komuna Lekaj	779	28.49%	780	28.58%
Komuna Gose	404	16.13%	567	20.53%
Komuna Sinaballaj	138	19.80%	74	11.64%
<b>2,748</b>	<b>21.69%</b>	<b>2,667</b>	<b>20.87%</b>	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Kamez</b>	8,975	30.51%	8,822	27.70%
Komuna Paskuqan	3,796	29.75%	4,205	28.98%
<b>12,771</b>	<b>30.30%</b>	<b>13,027</b>	<b>28.15%</b>	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Vore</b>	2,601	33.96%	1,811	20.60%
Komuna Berxulle	1,705	41.90%	1,627	37%
Komuna Preze	663	22.69%	1,000	33.17%
<b>4,969</b>	<b>32.85%</b>	<b>4,438</b>	<b>27.40%</b>	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Tirane</b>				
Njësia Bashkiake 1	5,933	31.78%	4,756	25.71%
Njësia Bashkiake 2	9,808	31.17%	7,904	25.50%
Njësia Bashkiake 3	5,088	29.70%	4,403	26.35%
Njësia Bashkiake 4	6,748	31.79%	6,246	29.06%
Njësia Bashkiake 5	8,921	26.75%	7,816	23.26%
Njësia Bashkiake 6	6,259	28.09%	5,835	24.30%
Njësia Bashkiake 7	8,243	30.64%	7,111	26.16%
Njësia Bashkiake 8	5,777	35.19%	5,208	32.14%
Njësia Bashkiake 9	7,460	33.21%	6,338	27.96%
Njësia Bashkiake 10	4,376	37.18%	3,533	29.75%
Njësia Bashkiake 11	8,207	34.43%	7,536	33.22%
Komuna Baldushk	729	25.54%	483	19.12%
Komuna Berzhite	836	27.37%	502	18.20%
Komuna Dajt	799	14.12%	993	17.15%
Komuna Farke	1,180	22.91%	1,323	26.48%
Komuna Kashar	2,488	25.51%	2,441	27%
Komuna Krabe	125	8.31%	162	11.37%
Komuna Ndroq	683	17.72%	557	15.77%
Komuna Petrele	951	26.86%	847	26.71%
Komuna Peze	188	7.21%	578	22.51%
Komuna Shengjergji	547	35.73%	371	26.90%
Komuna Vaqar	870	21.30%	850	20.26%
Komuna Zall-Bastar	415	15.72%	243	10.55%
Komuna Zall-Herr	756	16.27%	720	15.31%
<b>84,896</b>	<b>28.90%</b>	<b>76,755</b>	<b>26.08%</b>	

### PD/ QARKU FIER 2011-2015

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Fier</b>	4,939	17.81%	5,552	18.66%
Komuna Cakran	852	14.44%	1,073	18.62%
Komuna Dermenas	992	25.23%	932	23.36%
Komuna Frakull	791	20.62%	645	17.56%
Komuna Levan	785	15.62%	552	11.49%
Komuna Libofshe	614	16.03%	523	15.22%
Komuna Portez	536	13.95%	472	12.44%
Komuna Mbrostar	704	18.46%	845	21.71%
Komuna Qener(Clirim)	1,000	25.21%	788	20.34%
Komuna Topoje	371	12.36%	152	5.69%
<b>11,995</b>	<b>17.93%</b>	<b>11,534</b>	<b>17.57%</b>	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Roskovec</b>	819	24.80%	374	10.12%
Komuna Kuman	1,636	50.45%	649	18.71%
Komuna Kurjan	346	14.68%	327	15.10%
Komuna Strum	1,547	41.36%	676	16.10%
<b>4,348</b>	<b>32.80%</b>	<b>2,026</b>	<b>14.97%</b>	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Lushnje</b>	3,602	18.25%	5,084	25.97%
Komuna Allkaj	324	11.76%	242	9.55%
Komuna Ballagat	118	7.79%	125	10.15%
Komuna Bubullimë	710	20.39%	799	22.91%
Komuna Dushk	952	23.04%	729	20.43%
Komuna Fier-Shegan	508	13.72%	676	17.75%
Komuna Golem-Lushnje	341	13.56%	491	19.05%
Komuna Hysgjokaj	161	10.86%	208	16.22%
Komuna Karbunare	323	15.29%	334	16.15%
Komuna Kolonje	556	15.21%	708	20.16%
Komuna Krutje	484	9.72%	581	13.17%
<b>8079</b>	<b>45%</b>	<b>9,977</b>	<b>20.76%</b>	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Ballsh</b>	481	11.03%	482	10.49%
Komuna Aranitas	156	9.28%	173	9.57%
Komuna Ngracan	65	13.24%	75	17.20%
Komuna Qender	808	23.27%	282	7.19%
Mallakaster	82	12.02%	15	2.65%
Komuna Selite-Mallakaster	316	16.18%	275	13.60%
Komuna Fratar	85	11.38%	45	6.38%
Komuna Greshice	200	12.00%	162	9.20%
Komuna Hekal	148	11.48%	144	11.72%
Komuna Kute	2341	<del>43.30%</del>	1,653	9.70%

### PD/ QARKU DURRES 2011-2015

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Divjake</b>	598	10.83%	1,07	18.65%
Komuna Grabian	159	7.39%	586	27.46%
Komuna Gradisht	617	14.08%	643	14.41%
Komuna Remas	392	14.44%	502	18.92%
Komuna Terbuf	920	16.97%	981	18.62%
<b>2,686</b>	<b>12.70%</b>	<b>3,782</b>	<b>18.67%</b>	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Patos</b>	1,406	14.57%	1,48	14.33%
Komuna Ruzhdie	270	20.35%	196	15.57%
Komuna Zharrez	981	28.08%	660	18.68%
<b>2,657</b>	<b>21.00%</b>	<b>2,336</b>	<b>15.45%</b>	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Durres</b>	18,135	29.03%	16,566	23.94%
<b>Bashkia Manes</b>	763	19.77%	1,183	30.05%
<b>Bashkia Sukth</b>	1,949	28.16%	2,314	29.92%
<b>Komuna Ishem</b>	126	3.76%	736	24.08%
<b>Komuna Katundi I Ri</b>	1,380	29.18%	1,790	33.82%
<b>Komuna Rashbull</b>	3,578	41.76%	2,850	30.30%
<b>25931</b>	<b>26.27%</b>	<b>25,439</b>	<b>25.79%</b>	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Shijak</b>	1,107	23.12%	963	19.70%
Komuna Gjepalaj	532	23.20%	617	26.38%
Komuna Xhaminas	446	17.11%	426	16.81%
Komuna Hafizotaj	1,731	40.34%	2,126	35.39%
<b>3,816</b>	<b>2.78%</b>	<b>4,132</b>	<b>26.20%</b>	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Kruje</b>	1,152	15.44%	1,608	21.45%
<b>Bashkia Fushe-Kruje</b>	977	10.06%	1,553	14.92%
<b>Komuna Bubq</b>	262	7.64%	576	17.98%
<b>Komuna Cudhi</b>	83	4.90%	239	16.04%
<b>Komuna Koder-Thumane</b>	612	10.02%	906	14.74%
<b>Komuna Nikel</b>	629	13.15%	763	17.87%
<b>3,715</b>	<b>10.00%</b>	<b>5,645</b>	<b>17.10%</b>	





# Ja kryetarët e PS në Tiranë, Durrës e Fier që s'mund të rikandidojnë

## Kush janë komunitat dhe bashkitë të cilat kanë rënie nga viti 2011

ESIONA KONOMI  
TIRANË

**K**ryetarët e degëve të PS-së në bashkitë dhe komunitat që kanë marrë vota më pak se në zgjedhjet e kaluara, nuk do të kenë të drejtë të kandidojnë për zgjedhjet e reja brenda Partisë Socialiste. Ky kusht përjashtues është i cilësuar në listën e kriterëve që Kreu i Asamblesë Kombëtare, Gramoz Rucci, u ka shpërndarë degëve të partisë. Por kush janë degët në të cilat PS ka rënie? "Shqiptarja.com" ka marrë në shqyrtim 3 qarqet më të mëdha: Tiranën, Durrësin dhe Fierin. Në tabelat shoqëruese është krahasuar përqindja e votave të marra nga PS për këshill në zgjedhjet e mëparshme vendore të vitit 2011. Ky rezultat është krahasuar me atë të zgjedhjeve të fundit të 21 qershorit, ndaj ajo që rezultoi, është se shumica dërrmuese e kryetarëve aktualë, nuk do të mund të jenë më drejtues të partisë.

### TIRANË

Në bashkinë e madhe të

Tiranën sipas hartës së re, PS ka marrë 108,290 vota, ndërkohë që në vitin 2011, Tirana e vjetër së bashku me komunitat të cilat aktualisht janë përfshirë brenda Tiranës, por para 4 vitesh kanë qenë të veçuara, ka marrë 116,896 vota. Pra, dukshëm, PS në Tiranë ka një rënie prej 8,606 votash. Duke i parë në ndarjen sipas komunave, ato që kanë pësuar rënie janë Tirana qytet, Kërraba, Nd-roqi dhe Shëngjergji. Bashkia Kavajë pjesë e qarkut Tiranë, është e vetmja që ka shënuar

rritje për strukturat e partisë në këtë qark. Ajo ka marrë 6,100 në vitin 2011, dhe 7,962 në vitin 2015. Rrogzhina, Kamza, Paskuqani dhe Vora kanë shënuar ulje të ndjeshme

të votave krahasuar me zgjedhjet lokale të mëparshme.

### FIER

Edhe në Qarkun Fier, thujtaje në të gjitha bashkitë, përjashtuar Roskovecin, rezultati është në rënie. Për bashkinë Fier në vitin 2011 PS ka marrë 24,773 kundrejt 23,491 votave të marra në vitin 2015. Roskoveci është rritur me 1100 vota, ndërsa Bashkia e Lushnjës, ka një rënie nga 24,773 në 23,491 vota. Ballshi, Divjaka dhe Patosi po ashtu kanë rënie votash nga 500-1000 vota.



### RRITJA

Në tre qarqet e marra në analizë, Tiranë, Fier dhe Durrës, vetëm bashkitë Kavajë, Roskovec dhe Shijak kanë pësuar rritje. Krerët e këtyre degëve të PS-së, mund të rizgjidhen me strukturën e re.

### DURRËS

Shijaku është e vetmja degë e PS-së në qarkun Durrës që ka pësuar rritje. Aty nga 3,456 vota në 2011-ën, në 21 qershor janë marrë 4,575 vota për PS. Durrësi ka pësuar rënie, nga 29,850 në 26,823 vota. Rënie votash për PS ka dhe në Krujë, nga 4,274 në 3,847.

### PS/QARKU FIER 2011-2015

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Fier</b>	11,855	42.75%	10927	36.72
Komuna Cakran	1,819	30.82%	1906	33.07
Komuna Dermenas	1,135	28.87%	1152	28.88
Komuna Frakull	1,215	31.67%	1407	38.31
Komuna Levan	1,907	37.94%	1729	36.0
Komuna Libofshe	1,293	33.76%	1245	36.22
Komuna Portez	1,355	35.27%	1523	40.15
Komuna Mbrostar	1,438	37.70%	1103	28.33
Komuna Qener(Clirim)	1,789	45.11%	1510	38.97
Komuna Topoje	967	32.21%	989	37.04
	24,773		23491	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Roskovec</b>	1,058	32.03%	1123	30.38
Komuna Kuman	1,010	31.14%	1404	40.47
Komuna Kurjan	437	18.54%	653	30.15
Komuna Strum	1,454	38.88%	1907	45.42
	3,959		5087	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Lushnje</b>	7,948	40.27%	6379	32.59
Komuna Allkaj	694	25.19%	565	22.3
Komuna Ballagat	208	13.74%	347	28.19
Komuna Bubullime	1,015	29.15%	1113	31.92
Komuna Dushk	1,744	42.21%	1359	38.08
Komuna Fier-Shëgan	892	24.10%	932	24.47
Komuna Golem-Lushnje	859	34.17%	897	34.81
Komuna Hysgjokaj	244	16.46%	513	40.02
Komuna Karbunare	547	25.89%	477	23.07
Komuna Kolonje	827	22.62%	1105	31.46
Komuna Krutje	1,147	23.03%	1234	27.97
	16,125		14921	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Ballsh</b>	1,474	33.79%	876	19.06
Komuna Aranitas	447	26.59%	317	17.53
Komuna Ngracan	58	11.81%	73	16.74
Komuna Qender	913	26.29%	328	8.36
Komuna Selite-Mallakaster	116	17.01%	116	20.46
Komuna Fratar	470	24.07%	423	20.92
Komuna Greshice	164	21.95%	127	18.01
Komuna Hekal	514	30.85%	252	14.31
Komuna Kute	291	22.58%	360	29.29
	4,447		2872	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Divjake</b>	901	16.31%	1306	22.76%
<b>Komuna Grabian</b>	652	30.31%	559	26.19%
<b>Komuna Gradisht</b>	1,857	42.37%	1430	32.06%
<b>Komuna Remas</b>	510	18.79%	612	23.07%
<b>Komuna Terbuf</b>	1,921	35.44%	1742	33.06%
	5841		5649	

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Patos</b>	3,771	39.07%	3600	34.86
Komuna Ruzhdie	409	30.82%	307	24.38
Komuna Zharrez	1,243	35.59%	523	14.8
	5,423		4430	

### PS/QARKU TIRANË 2011-2015

	2011	%	2015	%
<b>Kavaje</b>	2,874	25.64%	4,402	31.52%
Komuna Helmes	486	27.02%	645	36.22%
Komuna Golem-Kavaje	958	22.41%	1,196	27.15%
Komuna Synej	732	25.60%	951	31.36%
Komuna Luz I Vogël	1,050	38.45%	768	27.87%
	6,100	27.82	7,962	30.69%

	2011	%	2015	%
<b>Rrogzohine</b>	1,231	32.08%	905	22.95%
Komuna Kryevidh	1,136	39.46%	551	20.33%
Komuna Lekaj	706	25.82%	849	31.11%
Komuna Gose	450	17.97%	377	13.65%
Komuna Sinaballaj	289	41.46%	183	28.77%
	3,812	31.34	2,865	22.42%

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Kamez</b>	6,465	21.98%	5,415	17.05%
Komuna Paskuqan	2,962	23.22%	2,853	19.66%
	9,427	45.2	8,268	17.87%

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Vore</b>	2,522	32.93%	1,141	12.98%
Komuna Bexulle	769	18.90%	504	11.48%
Komuna Preze	456	15.61%	658	21.82%
	3,747	22.53	2,303	14.22%

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Tirane</b>	104,785	42.25%	91530	39.26
Komuna Baldushk	519	18.19%	802	31.75%
Komuna Berzhite	617	20.20%	788	28.57%
Komuna Dajt	1,362	24.07%	2,433	42.02%
Komuna Farke	1,149	22.31%	1,317	26.36%
Komuna Kashar	2,298	23.56%	2,567	28.39%
Komuna Krrabe	259	17.21%	234	16.42%
Komuna Ndroq	1,572	40.78%	1,449	41.02%
Komuna Petrele	968	27.34%	1,279	40.33%
Komuna Peze	478	18.33%	945	36.80%
Komuna Shëngjergji	455	29.72%	410	29.73%
Komuna Vaqar	1,304	31.92%	2,095	49.94%
Komuna Zall-Bastar	297	11.25%	1,009	43.79%
Komuna Zall-Herr	833	17.93%	1,009	43.79%
	116,896		108,29	36.80%

### PS/QARKU DURRËS 2011-2015

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Durres</b>	23,779	38.07%	21935	31.69%
<b>Bashkia Manez</b>	965	25.00%	910	23.11%
<b>Bashkia Sukth</b>	1,338	19.33%	1125	14.55%
Komuna Ishem	281	8.39%	695	22.74%
Komuna Katundi I Ri	659	13.93%	1079	20.39%
Komuna Rashbull	2,828	33.01%	1079	20.39%
	29,850	22.95%	26823	22.14%

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Shijak</b>	1,253	26.17%	1185	24.24%
Komuna Gjepealaj	575	25.08%	750	32.06%
Komuna Maminas	777	29.82%	738	29.12%
Komuna Xhafzotaj	851	19.83%	1902	31.66%
	3,456	25.2	4575	29.27

	2011	%	2015	%
<b>Bashkia Kruje</b>	731	9.80%	922	12.30%
<b>Bashkia Fushe-Kruje</b>	1,705	17.55%	1494	14.36%
Komuna Bubq	561	16.36%	680	21.23%
Komuna Cudhi	75	4.42%	113	7.58%
Komuna Koder-Thumane	1,097	17.96%	850	13.83%
Komuna Nikel	836	17.47%	710	16.63%
	4,274	13.92	3847	14.32

# Ambasada e SHBA: Turp që keni një deputet të dënuar

## “Qeveria bëri përparim të mirë dhe vazhdon të bëjë përpjekje domethënëse”

**S**HBA duket do t'i shkojë deri në fund denoncimit të deputetit shqiptar, i cili është dënuar për favorizim të prostitucionit. Kështu, Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për një deputet shqiptar të dënuar për trafik qeniesh njerëzore është konsideruar nga Ambasada e SHBA si një gjë e turpshme. Qëndrimi i fortë erdhi në një reagim të selisë diplomatike pas publikimit të raportit vijtor për trafikun. Ky rast i ka dhënë shtysë ambasadës që të ripërsërisë edhe njëherë kërkesën për dekriminalizimin të politikës shqiptare. “Ambasada vlerëson si të turpshme që ka një anëtar të parlamentit shqiptar me dënime për trafikimin e qenieve njerëzore. Shqiptarët kanë të drejtën të kenë përfaqësues të zgjedhur me integritet e standarde të larta etike, jo kriminelë. Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë t'i kërkojnë të gjitha partive politike që t'i mbajnë individët me të shkuar kriminale larg jetës politike dhe publike të Shqipërisë”, thuhet në deklaratën e dalë nga ambasada e SHBA në Tiranë. Megjithatë në reagimin e saj zyrtar ambasada Amerikane dhe pse ngre shqetësimin e nivelin e trafikimit të qenieve njerëzore vlerëson përpjekjet e qeverisë. Ambasada gjithashtu nxit qeverinë që të shtojë edhe më shumë përp-

jekjet që Shqipëria të dalë nga harta e vendit origjinë të trafikut të qenieve njerëzore. “Në vijim të interesimit nga media

për Raportin e Departamentit të Shtetit për Trafikimin e Personave për 2015, Ambasada e SHBA dëshiron të vërë

në dukje se raporti vlerëson se Qeveria e Shqipërisë bëri përparim të mirë dhe vazhdon të bëjë përpjekje domethënëse

për të përbushur standardet minimale për eliminimin e trafikut. Ne nxisim qeverinë shqiptare t'i vazhdojë ato përpjekje për të luftuar të gjitha format e trafikimit të njerëzve nëpërmjet zbatimit të fortë të ligjit dhe mbrojtjes efektive të viktimave, si dhe me politika për parandalimin e trafikimit. Shtetet e Bashkuara janë të angazhuara të punojnë me Shqipërinë për të mbështetur përpjekjet e vazhduara kundër trafikimit të njerëzve”, thuhet në deklaratën e Ambasadës së SHBA. Dy ditë më parë DASH që në raportin e saj ka nënvizuar faktin se Shqipëria është një vend burimi për trafikimin e burave, grave dhe fëmijëve, që i nënshtrohen trafikimit seksual dhe punës së detyruar. Kritika të forta janë adresuar edhe ndaj institucioneve për shkallën e lartë të korrupsionit në radhët e policisë. DASH ka vlerësuar edhe disa nga përpjekjet e qeverisë shqiptare për zbatimin e ligjit kundër trafikimit, siç është Kodi Penal ku parashikohet dënime nga 8-15 vjet burgim. Qeveria sipas raportit të DASH ndoqi penalisht 18 të pandehur më m 2014, rritje të madhe nga tre të ndjekur penalisht më 2013. Por ajo që bie në sy në këtë raport është evidencimi i faktit se një deputet shqiptar megjithëse ishte dënuar më parë për lidhje kriminale me trafik, vazhdon të jetë pjesë e Kuvendit.

### Gjebrea:

## Në shtator nis pastrimi i politikës nga krimi

**N**ë shtator nis pastrimi i politikës nga të inkriminuarit. Duke marrë shkas nga raporti i DASH që përmend një deputeti të parlamentit shqiptar të përfshirë në trafikë, Ministria e Brendshme tha se do nisë procesin e dekriminalizimit. “Lidhur me rastin e deputetit të përmendur në raport ju bëjmë dije se nga shtatori i ardhshëm Qeveria shqiptare është tërësisht e angazhuar të hartojë bashkë me partnerët, një kuadër ligjor specifik për të plotësuar standardet më të larta që do i

japin zgjidhje njëherë e mirë kësaj çështjeje kaq të debatuar”, tha Gjebrea. Zv.ministria tha se nga shtatori qeveria do angazhohet bashkë me partnerët e huaj për hartimin e një kuadri të ri ligjor. “Kujtoj këtu se vendi ynë që prej vitit të kaluar, kur doli nga lista e vendeve nën vëzhgim dhe i vendos në kategorinë 2, renditet sërish në kategorinë e vendeve që kanë rritur përpjekjet për zbatimin e ligjit kundër trafikimit”, deklaroi zv.ministria e Brendshme.



### APELI

“Ambasada vlerëson si të turpshme që ka një anëtar të parlamentit shqiptar me dënime për trafikimin e qenieve njerëzore. Shqiptarët kanë të drejtën të kenë përfaqësues të zgjedhur me integritet, jo kriminelë”.



## DASH/Basha: Rama-Meta ortakë me kriminelët, i emërojnë

**L**ideri i opozitës Lulzim Basha e ka përkthyer në një shqetësim të madh për shoqërinë shqiptare raportin e DASH që evidenton faktin se një deputet i Kuvendit është i dënuar për veprimtari kriminale të trafikimit. Ai tha se ky raport është tregues që dy aleatët në qeverisje Edi Rama e Ilir Meta nuk ndahen dot nga ortakët e tyre kriminelë që sipas Bashës i sollën në pushtet, madje i emërojnë në postet më të larta. Kreu i PD deklaroi se përballë shqetësimit të ngritur ju vetëm nga opozita, por tashmë edhe nga SHBA, të vetmit që qëndrojnë në heshtje janë aleatët Rama e Meta, që Basha nuk ngurron t'i quajë vetë problem. “Edi Rama që e ka krijuar problemin nuk mund të fshihet pafund prapa gjethes së fikut. Nuk flet dyshja Rama-Meta sepse janë ata vetë që i qëmtuan e i sollën trafikantët dhe kriminelët e dënuar apo në kërkim. Janë ata që mbrojtën, rehabilituan e kandiduan Ndokën, Prengën, Frukun, Bushin, Roshin, Peçin, Ndonin e dhjetëra të tjerë e duke sfiduar hapur publikun, opozitën e aleatët tanë amerikanë dhe evropianë”, tha Basha.

## Kreu i Kuvendit Meta: Lufta ndaj krimit do jetë pa kompromis

**P**as deklaratën e Ambasadës Amerikane në lidhje me raportin e publikuar nga DASH mbi trafikimin e qenieve njerëzore ka reaguar kryeparlamentari Ilir Meta. Ai apelon e kërkon nga të gjitha strukturat e zbatimit të ligjit që në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, të rrisin nivelin e profesionalizmit, të luftojnë pa asnjë kompromis, si dhe të çojnë përpara drejtësisë gjithë të inkriminuarit e përfshirë në veprimtari të paligjshme të trafikeve të çdo lloji. Ai përsëritet dhe vlerëson Raportin e sapublikuar të DASH për Trafikimin e Personave, ku vlerësohet përparimi i angazhimit dhe përpjekjeve të Qeverisë Shqiptare në luftën e vazhdueshme ndaj këtij fenomeni dhe aktiviteti kriminal. Ai vlerëson se lufta e pandërprerë ndaj krimit e korrupsionit është një sfidë e rëndësishme që kërkon modernizimin e shtetit, përkushtim, profesionalizëm, transparencë dhe mbështet procesin e dekriminalizimit përmes rritjes së standardeve ligjore për të gjithë përfaqësuesit publik të zgjedhur apo të emëruar.

### LAJME shkurt

## Dështon përsëri Këshilli Bashkiak në Mallakastër

Bojkoti që të majtët i bënë mbledhjes së Këshillit Bashkiak në Mallakastër ka çuar në dështimin e dytë brenda 1 javë të konstituimit të këtij këshilli. Agron Kapllanaj, i cili pritet të marrë detyrën si kryebashkiak, tha: “U kam bërë një ofertë të dy forcave politike, me mirëkuptim duke tërhequr kandidatin për kryetar të Këshillit bashkiak të forcës së djathtë. Për hir të qytetarëve mallakastriotë ne s'duam të vazhdojmë me bojkote ky këshill dhe tërheqim kandidaturën tonë”.



## KQZ vendos hapjen e kutive në Bashkinë e Sarandës

KQZ shqyrtoi dje projektvendimin “Për hapjen e kutive të materialeve zgjedhore të disa qendrave të votimit të KZAZ-88, Bashkia Sarandë, të përdorura në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015”. KQZ vendosi të hapë kutitë e materialeve zgjedhore në disa qendra votimi të bashkisë Sarandë, për të nxjerrë tabletat elektronike, të cilat u përdoren për realizimin e projektit pilot në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21.06.2015.

## Pukë, nis këshilli bashkiak Gjonaj: Fund korrupsionit

Këshilli bashkiak i Pukës është konstituuar ditën e djeshme. Kryebashkiaku i ri, Gjon Gjonaj deklaroi se me ardhjen e tij në pushtet do t'i jepet fund korrupsionit dhe nepotizimit në administratë. Gjithashtu ai theksoi se do jetë në shërbim të qytetarëve. “Do jem shërbëtori i pukjanëve. Do t'i jap fund korrupsionit dhe nepotizmit”, tha Gjonaj.

## SHPALLJE ANKANDI

Shoqëria Përmbartimore “616/A” shpk, shpall shitjen në ankand për pasurinë “Apartament”, me sip. 74.5 m2, me numër pasurie 4 / 346 + 1 -28, Vol. 20, Faqe 147, ZK 8581, me adresë Lagjia nr. 2, Rruga “Rinia”, Pogradec. Pasuria nxiret në ankand me vlerën fillestare 2.016.000 (dymilion e gjashtëmbëdhjetë lekë. Ankandi zhvillohet në datën 29.07.2015.

Personat e interesuar mund të paraqiten në adresën Lagjia nr.3, Rruga “Naim Frashëri”, Pogradec ose të kontaktojnë në numrin 0697251504 ose në e-mail: shoqeria616a@gmail.com



# Rama: S'lejojmë asnjë HEC e minierë që dëmton

## Projektligj për ndalimin e investimeve në zona të mbrojtura, nuk preken projektet aktuale

**Q**everia shqiptare paralajmëron se nuk do lejojë asnjë investim në kurriz të shkatërrimit të mjedisit. Ka qenë kryeministri Edi Rama që në tryezën me investitorët bëri të qartë se qeveria do ndalojë lidhjen e kontratave për çdo ndërtim në zonat e mbrojtura. Ndërsa propozimi i shumicës qeverisëse për ndryshimin e ligjit nuk do të prekë ata investitorë, kryesisht në sektorin energjetik e minierar që i kanë zhvilluar projektet e tyre ose që janë në proces, edhe pse këto leje për HEC-e apo shfrytëzimin e minierave janë dhënë në zona të mbrojtura mjedisore. Rama deklaroi se nuk do lejojë sakrificimin e të ardhmes së brezave të rinj përballë "babëzisë" për investime. "Qeveria është angazhuar për të rivendosur rendin ligjor në

### MINISTRI

#### Gjignuri: Në sitë dhe kontratat aktuale që janë me probleme

Ministri i Energjisë Damian Gjignuri u shpreh në takim se janë disa kontrata në fuqi të cilat do të ndalohen për shkak të problematikave që kanë. "Do të arrijmë ekuilibrin e duhur mes zhvillimit ekonomik duke respektuar standardet mjedisore. Të mos lejojmë më ndërtimin e HEC-eve në zona të mbrojtura, janë disa kontrata në fuqi me gjithë problematikën që ato shfaqin, por nuk do të lejojmë në vijim. Kontratrat që janë duke u zhvilluar nuk do të preken, do të vazhdojnë të përfundojnë projektin e tyre. Një pjesë e kontratave me HEC kanë dështuar, një pjesë e tyre po zhvillohen. Ato që nuk marrin në konsideratë mjedisin pavarësisht se kemi nevojë për investime nuk mund të sakrifikojmë të ardhmen e vendit. Sektori minierar ka problema për shkak të fragmentimit të lejeve të minierave. Gjetëm 1100 leje, bëmë revokime, hoqën lejet e fjetura që nuk kontribuonin më për buxhetin e shtetit dhe ky numër është reduktuar thujse në gjysmë", tha Gjignuri.

këtë terren ku ka ende shumë për të bërë. Dy momente me rëndësi themelore që janë adresuar në këtë periudhë kanë pasur të bëjnë me minierat dhe me HEC-et për të krijuar një ekuilibër sa më të natyreshëm mes nevojës së pandalshme për zhvillim dhe që ky zhvillim të mos cenojë të ardhmen e vendit dhe të mos ndodhë në kurriz të gjeneratave të tjera. Në vitet e shkuara kemi pasur një zhvillim të paqëndrueshëm ku të drejtat e zhvillimit janë dhënë pa hesap e pa drejtuar mekanizmat e domosdoshëm për të monitoruar detyrimet që burojnë nga këto të drejta. Ka disa shembuj shumë domethënës lidhur me faktin se shumë kompani që kanë operuar në sektorin e minierave dhe ndërtimin e HEC-eve vazhdojnë t'i kenë detyrime të rënda shoqërisë dhe një pjesë e tyre për vite



të tëra as nuk kanë denjuar të paguajnë garancinë e rehabilitimit. Në të shkuarën batërdia e korrupsionit dhe e këtij modeli zhvillimi ka sjellë një numër të drejtash apo lejesh të dhëna për HEC ndër të cilat 113 janë drejtpërdrejtë në zona të mbrojtura, të caktuara ligjërisht si zona të paprekshme nga rrugët e zhvillimit, 42 janë në prodhim, 23 janë në proces, 48 të tjera nuk kanë filluar punë dhe nuk do të fillojnë, pasi në projektligjin që propozohet për të rishikuar lejet e dhëna do ndalohet ndërtimi i HEC-eve apo çdo lloj tjetër aktiviteti në zonat e mbrojtura,

tha Rama. Sipas kryeministrit ka modele të investitorëve të cilët i zbatojnë në përpikmëri kontratat dhe që kanë ndikuar në rritjen e punësimit në Shqipëri. "Në projektligjin e ri është detyrimi për të bërë rivlerësimet nga të gjithat institucionet përkatëse. Do vazhdojmë të mbështesim rritjen e kapaciteteve që po ndodh në mënyrë të vazhdueshme në sektorin e minierave, çka ka sjell rritje të punësimit dhe shpërbëmt të minierave. Jemi po ashtu të kënaqur edhe me punën në sektorin e energjisë", tha Rama.

### RENDI I MBLEDHJES

## Marrëveshja, Brunilda Paskali e LSI Nënkyetare e bashkisë

### Të enjten mblidhet këshilli i Tiranës

**P**as Andi Seferit të FRD-së, edhe LSI ka zyrtarizuar emrin e saj për nënkryetar të bashkisë Tiranë. Ajo është Brunilda Paskali dhe mban postin e zv.ministres së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Erjon Veliaj këtë të enjte do të bëjë betimin në detyrën e tij të re si kryebashkiak i Tiranës. Pas betimit, i cili është caktuar në mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak, Veliaj do të nisë menjëherë punën. Kryebashkiaku i ri i Tiranës, i zgjedhur me votat e qytetarëve më 21 qershor, do të mbajë edhe një fjalim në mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak. Ndërkohë që pritet që në ceremoninë e dorëzimit të detyrës të jenë dhe drejtues aktual të Bashkisë, Tashmë ka përfunduar puna për përgatitjen e dosjeve që do të jepen në dorëzim stafit të kryetarit të ri të bashkisë së Tiranës. Në mbledhjen e parë të këshillit bashkiak do të votohen dhe drejtuesit e rinj të këshillit. Fillimisht puna do të nisë me zgjedhjen e Komisionit të Mandateve. Ky i fundit do të përgatis raportin e posaçëm për dokumentet e dorëzuar nga të zgjedhurit e rinj, për të legjitimuar kështu dhe nisjen e punës prej këshillit bashkiak.



### BISEDIMET

**Krerët e koalicionit të majtë janë në përfundim të bisedimeve për emrat e nënkryetarëve të Bashkisë së Tiranës, por dhe të administratorëve që do të jenë në 11 minibuset që do të kenë komonat që janë bërë pjesë e bashkisë së madhe**

Pas miratimit të raportit të komisionit këshilltarët e rinj, si dhe kryetari i ri i Bashkisë Erjon Veliaj do të bëjë betimin. Përfundimi i kësaj procedure do të hapë rrugën votimit të parë në këshillin bashkiak. Të

61 të zgjedhurit do të votojnë për kryetarin e Këshillit I cili pritet të përfaqësojë Partisë Socialiste. Pas kësaj do të votohen dhe nënkryetarët e këshillit bashkiak, ku do të kenë të drejtën e propozimit dhe aleatët. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Bashkiak. Pika e radhës në rendin e ditës është shpallja e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe betimi i tij. Ndërsa në pikën e fundit është vendosur zgjedhja e anëtarëve që do të përfaqësojnë Këshillin Bashkiak në Këshillin e Qarkut të Tiranës. Pas kësaj Veliaj do të nisë punën në përgatitjen e vendimeve të para të këshillit bashkiak.

### FTESE PER SHPREHJE INTERESI

#### PER PRONA TE PALUAJTSHME

INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA Sh.a.

Fton publikun e gjerë të shprehë interesin për blerjen e pronave të mëposhtme, në pronësi të Bankës.

Ju lutemi të vizitoni [www.intesasnpaolobank.al](http://www.intesasnpaolobank.al) për detaje të pronave si fotografi, vendodhje hartografike dhe çmimin minimal të pranueshëm. Aty do të gjeni edhe pronat e tjera nga publikimet e mëparshme.

Jeni të lutur të shprehni interesin tuaj deri me datën **10 Gusht 2015** në adresën: [prona@intesasnpaolobank.al](mailto:prona@intesasnpaolobank.al), ku mund të na kontaktoni edhe për të kërkuar sqarime të mëtejshme.

Nr.	ID e Pronës	Rrethi / Qyteti	Kategori	Sipërfaqe m2
1	83	Tiranë	Apartament + Truall	51.38+48.18
2	86	Tiranë / Lundër	Vilë 2Kate+Paparfingot+Truall	Baza 132+500
3	92	Tiranë	Apartament + Verandë	90+88
4	93	Tiranë / Kallmet	Tokë Arë	7,000
5	98	Tiranë / Mëzez	Apartament	138
6	100	Tiranë	Njësi Shërbimi	250
7	101	Tiranë	Njësi Shërbimi	250
8	74+75	Durrës / Prezë	Tokë Arë	500+500
9	76	Durrës / Rade	Truall + Shtëpi 2 Kate	520+132 baza
10	78	Durrës / Xhafzotaj	Tokë Arë	3,585
11	95	Durrës	Apartament	80
12	94	Elbasan	Apartament	98
13	87-90	Kavajë / Golem	4 Njësi Tregtare	49+59+22+86
14	91	Kavajë / Karpen	Tokë Arë	1,000
15	84	Vlorë / Mifol	Kantier Ndërtimi	15,310
16	96	Vlorë	Apartament	134
17	99	Vlorë	Apartament	80
18	82	Tepelenë / Memalaj	Tokë - fushë minifutboll	1,200
19	97	Lezhë / Gryk Lumi	Tokë Arë	5,250
20	44-47 +52-73	Shkodër	11 Apartamente + 15 Njësi	70 - 305
21	77	Shkodër/Guci e Re	Tokë Arë	13,208
22	79	Shkodër	Truall + Ndërtesë	105+77
23	80	Dibër / Peshkopi	Shtëpi 3 Kate	Baza 144
24	81	Dibër / Peshkopi	Njësi Tregtare	150+80

INTESA SANPAOLO BANK

NJE BOTE MUNDËSHJE REALE



TEL: +355 4 22 76 375

[www.intesasnpaolobank.al](http://www.intesasnpaolobank.al)  
BANK OF INTESA SAN PAOLO GROUP  
INTESA SANPAOLO

JONIADA KOÇI TIRANË

Mazhoranca nuk ka ndërmend të heqë dorë nga krijimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit. Madje sipas kryetarit të komisionit të Sigurisë Spartak Braho ligji po punohet duke reflektuar në të vendimin e kushtetueses që e rrëzoi FBI-në shqiptare pak muaj më parë. Në një intervistë për A1 Report, Braho jep gjithë detajet e ligjit të ri që do jetë gati në shtator. Shumica e majtë ka nisur punën për të rindërtuar byronë e hetimit që ia rrëzoi pak muaj më parë Gjykata Kushtetuese. E pagëzuar si "FBI-ja shqiptare", Byroja do të riformulohet duke mos e dubluar prokurorinë e cila me formulën e re do të pyetet dhe do të drejtojë çdo hetim. Detajet e ligjit të ri të përshtatur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për A1 Report i shpjegon kreu i komisionit të sigurisë Spartak Braho. "E tërë veprimtaria e byrosë kombëtare të hetimit do të trajtohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Padyshim që do të ketë riformulime dhe rispecifikime më të sakta për të hequr çdo paqartësi që krijohet nga formulimet e para. Është një strukturë që do të drejtohet nga pikëpamja administrative nga Policia e Shtetit dhe nga pikëpamja ligjore do të drejtohet nga Prokurori i Përgjithshëm apo prokurorët sipas seksioneve në rrethe. Në sesionin e shtatorit është një ndër ligjet që do të bëhen pjesë e axhendës së Kuvendit", tha

LIGJI Byroja Kombëtare e Hetimit kaloi në Parlament si pjesë e ligjit për "Policinë e Shtetit". Ishte parashikuar te ngrihej në Ministrinë e Brendshme me detyrën për të hetuar veprat penale në fushën e korrupsionit.



OPOZITA Më 9 tetor 2014, Partia Demokratike dorëzoi padinë për të shpallur antikushtetuese Byronë e Hetimit. Në fillim të muajit prill, në vendin tonë mbërritën për këtë çështje edhe dy ekspertë të FBI-së.

analizoi pretendimet e ngritura nga 1/5 e deputetëve të PD si dhe prapësimet e paraqitura nga subjekti i interesuar bazuar në nenin 131 dhe 134 të Kushtetutës vendosi : - Shpalljen si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të Kreut VI "Byroja Kombëtare e Hetimit (nenet 27-36) të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit" si edhe rrezimin e kërkesës për shfuqizimin e nenit 49 të këtij ligji. Byroja Kombëtare e Hetimit kaloi në Parlament si pjesë e ligjit për "Policinë e Shtetit". Ishte parashikuar te ngrihej si pjesë e Ministrisë së Brendshme me detyrën për të hetuar veprat penale në fushën e korrupsionit. Në fillim të muajit prill, në vendin tonë mbërritën për këtë çështje edhe dy ekspertë të FBI-së, të cilët zhvilluan një takim me ministrin e Brendshëm për të dhënë ekspertizën e tyre për ngritjen e efikasitetit të strukturës së Byrosë së Hetimit, e deklaruar se do të luftonte korrupsionin dhe krimin e organizuar në vend. Më 9 tetor 2014, Partia Demokratike dorëzoi padinë për të shpallur antikushtetuese Byronë e Hetimit. Një vendim i tillë vjen pak ditë pasi u deklarua se FBI do të angazhohet në ngritjen e plotë dhe funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Një muaj pasi Gjykata Kushtetuese e rrëzoi vendimin e qeverisë për ngritjen e kësaj strukture të re hetimore Richard Miller, Drejtor i Përgjithshëm i ICITAP në SH.B.A ka vlerësuar bashkëpunimin me policinë e shtetit për ngritjen e Byrosë së hetimit.

# Qeveria s'heq dorë nga "FBI", Braho: Gati Byroja

## Drafti fillestar i Byrosë Kombëtare të Hetimit u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese

Braho. Po si do të harmonizohet Byroja me kushtetutën dhe të dakordsohen kompetencat e saj me prokurorinë? "Kjo strukturë do të jetë kombëtare e ndarë në të gjitha degët që ka Ministria e Brendshme në shkallë rrethesh apo qarqesh port të gjitha veprimet hetimore procedurale do të zhvillohen nën drejtimin e prokurorisë, është prokuroria ajo që do të japë leje për gjurmime, për hetime, për investigime",



thotë Braho për A1 Report. Gjykata Kushtetuese shpalli në 17 prill të papajtueshmë me Kushtetutën ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ankimi i dërgua në gjykatë tetorin e vitit të shkuar nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike i cili vlerësonte se kjo strukturë merret shërbimin ekskluziv të Prokurorisë. Në njoftimin për shtyp të 17 prillit 2015, të Gjykatës Kushtetuese thuhet se pasi shqyrtoi dhe

### LAJME SHKURT



#### Auditimi i fushatës politike, mbi 20 ekspertë, kërkesë në KQZ

Të paktën 20 ekspertë kontabël janë regjistruar për të monitoruar fondet e partive politike gjatë fushatës së zgjedhjeve vendore. Pas deklarimit të dy ditëve më parë nga përfaqësues të Shoqatës së kontabilitetit, se auditimi i shpenzimeve po shkon drejt dështimit, burime pranë KQZ bëjnë me dije se shqetësimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është zgjidhur, duke qënë se nga lista prej 121 audituesish që janë në institutin e ekspertëve kontabël të autorizuar, kanë shfaqur interese më shumë se 20 të tillë, ndërsa kanë afat për të dorëzuar kërkesë në KQZ deri me datën 3 gusht.

#### KQZ nuk ndryshon shpërndarjen e mandateve për Pogradecin

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me 1 votë pro dhe 5 vota kundër rrëzoi dje pr'aktin që propozonte një ndryshim në vendimin për shpërndarjen e mandateve për këshillin e Bashkisë Pogradec, Qarku Korçë. Propozimi i sjellë nga administrata zgjedhore synonte korriginimin e një gabimi në vendimin nr.920 të KQZ-së për shpërndarjen e mandateve të këshillit bashkiak të Pogradecit. Sipas bazës elektronike të të dhënave, nuk është pasqyruar saktë rezultati i votave për qendrën e votimit 38.921, ku 7 vota që i përkasin subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Moderuar, i janë hedhur gabimisht subjektit Partia Demokratiane.



#### STUDIO PËRMBARIMORE "SPEED SOLUTION" NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 2 PER:

"Apartament", me sip 55 m2, me nr.pasurie 111/52+1-1, Z.k.2291, Volumi 24, faqe 175 me adresë Kryemëdhenj Kavajë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të BANKA E TIRANËS sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **1,680,000 (një milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë.**

"Garazhi", me sip 78.5 m2, me nr.pasurie 111/52+1-1, Z.k.2291, Volumi 24, faqe 177 me adresë Kryemëdhenj Kavajë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të BANKA E TIRANËS sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **1,848,000 (një milionë tetëqind e dyzet e tetë mijë) Lekë**

Ankandi do të zhvillohet më datë **17.08.2015, Ora 16:00**, pranë Studios Përmbarimore "SPEED SOLUTION" me Adresë: Bulevardi "Gjergj FISHTA" Kulla 1, Kat, 2, Nr.3, Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni cel. 0693041355, 0696334695 email: speed.solution@yahoo.com



#### Meta: Fëmijët shqiptarë në Mal të Zi, me abetare të njehsuar

Fëmijët shqiptarë në Mal të Zi, të cilët do të shkojnë për herë të parë në shkollë, do të mësojnë gjuhën shqipe me abetaren e njehsuar kombëtare. Lajmi e dha nga Ulqini kryetari i Kuvendit Ilir Meta, i cili mori pjesë në ceremoninë e hapjes së panairit të librit. Panairi i 15-të i librit, që po mbahet në plazhin e vogël të Ulqinit në Malin e Zi, ka bërë bashkë politikanë, shkryrtarë e akademikë nga Shqipëria, Mali i Zi, Kosova e Maqedonia. Meta deklaroi se ofrimi i këtij bashkimi përmes librit është një bashkim mjaft i fuqishëm dhe mjaft domethënës për të ardhmen tonë të përbashkët në BE.

#### KQZ shpërndan mandatet për këshillin Bashkiak Shkodër

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e ditës së djeshme, shqyrtoi e vendosi të shpërndajë mandatet për koalicionet zgjedhore dhe partitë që konkurojnë më vete, për këshillin e bashkisë Shkodër, qarku Shkodër dhe të shpallë kandidatët fitues nga listat shumemërore të partive politike të miratuara nga KQZ. Kështu, Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet, mori 27 mandate, Aleanca për Shqipërinë Europiane, 23 mandate dhe Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, 1 mandat. Garën për kreun e kësaj bashkie e fitoi kandidatja e djathtë Voltana Ademi.

#### Nënshkruhet marrëveshja midis ATSH-së dhe PETRA

Agjencia Telegrafike Shqiptare ka nënshkruar një marrëveshje bashkpunimi me Agjencisë jordanaze të lajmeve PETRA. Marrëveshja parashikon shkëmbimin e lajmeve, fotove dhe videove për zhvillimet politike, ekonomike, sociale, kulturore e më gjerë për të dy vendet: Shqipërinë dhe Jordaninë. Drejtori

i Përgjithshëm i ATSH-së, Gëzim Podgorica, pas nënshkrimit të marrëveshjes me Amann të Jordanisë, tha se ajo është një "një urë e re dhe e domosdoshme komunikimi për të dy vendet". Edhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë PETRA, Faisal Al Shboul vlerësoi marrëveshjen midis dy vendeve.



# KLSH, në prokurori ish-drejtori i Qytetit Studenti

## Shkelje me tenderat, me dhënien me qira të objekteve e me gjyqet

LORENC RABETA  
TIRANE

Shkeljet me tenderat, në dhënien me qira të objekteve dhe mosderdhjen e të ardhurave prej tyre, apo me shpenzimet gjyqësore, kanë bërë që KLSH të dërgojë për ndjekje penale ish-drejtorin e "Rezidencës Studentore Universitare nr.1", Bujar Brovina. Në një deklaratë zyrtare Kontrolli i Lartë i Shtetit bën me dije se dëmi ekonomik i konstatuar gjatë auditit të këtij institucioni i kalon 20 milionë lekët dhe se bashkë me Brovinën është dërguar për ndjekje penale edhe ish-zëvendësi i tij bashkë me katër punonjës të tjerë. "Nga auditimi rezultuan një sërë shkeljesh dhe parregullsish për sa i përket mungesës së dokumentacionit ligjor të kontratave të lidhura për objektet e dhëna me qira; moslogaritjes dhe mosderdhjes së detyrimeve për objektet e dhëna me qira në buxhetin e shtetit; moskryerjes së detyrimeve të procedurave të prokurimit, si dhe shkaktit të shpenzimeve të tepërta gjyqësore si pasojë e mosndjekjes së proceseve gjyqësore", thekson KLSH në deklaratë.

### TENDERAT

KLSH ka konstatuar se në tenderat e zhvilluara gjatë viteve 2010-2011, ishte përdorur një standard i dyfishtë për sa i përket vlerësimit të kriterëve kualifikues të operatorëve ekonomikë

### TENDERAT

KLSH ka konstatuar se në procedurat e prokurimit publik, të zhvilluara gjatë viteve 2010-2011, ishte përdorur një standard i dyfishtë për sa i përket vlerësimit të kriterëve kualifikues të operatorëve

### PAGESAT

Në një rast ishte kryer pagesa në vlerë 252,600 lekë, pa asnjë dokumentet justifikues dhe në dy raste, me vlerë totale prej 586,320 lekë, ishte paguar një subjekt vetëm me kontratë të lidhur nga ish-administratori

ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kështu, nga auditimi rezultoi se në 10 procedura prokurimi, për të njëjtat mangësi që ishin skualifikuar disa operatorë ekonomik, disa operatorë të tjerë nuk ishin skualifikuar,

### KONTRATAT

U evidentuan një sërë mangësisht për sa i përket plotësimit të dokumentacionit në dosjet e kontratave të nënshkruara me subjektet të cilat kanë marrë me qira ambientet për periudhën 2012-2014

por ishin shpallur fitues. Po ashtu nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2012, u konstatua se në të gjitha rastet, drejtuesit teknik për ndjekjen e punimeve ishin caktuar sipas urdhrave të dala



Bujar Leskaj

nga titullari, duke anashkaluar dhe duke mos zbatuar rregullat e Prokurimit Publik. Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt "Rikonstrukcion i godinës nr. 1, të qytetit studentit", "Lyerje e godinave nr. 1-12, 4-17, 20-21, të qytetit të studentit për vitin 2012" dhe "Hidroizolim tarrace të godinave nr. 4,12, dhe 13, dhe 7-8, si dhe bibliotekës së qytetit të studentit", vlera totale e të cilave arrinte në 2,458,255 lekë, rezultoi se ishin anashkaluar procedurat e prokurimit duke mos qenë në kushtet e emergjencës,

pasi këto shërbime duhet të kryheshin me procedura të reja prokurimi.

### KONTRATAT

Gjithashtu nga auditimi u evidentuan një sërë mangësisht për sa i përket plotësimit të dokumentacionit në dosjet e kontratave të nënshkruara me subjektet të cilat kanë marrë me qira ambientet e "Trajtimin të studentëve Nr. 1", sha, Tiranë, për periudhën 2012-2014, ndërsa për periudhën 2012-2013, rezultoi që nuk ishte kryer monitorimi i kontratave të qirasë ose enfitotezës.

## TREGTIA ME JASHTË

# Qershor, Rritet 11,5% volumi i eksporteve me Greqinë

## INSTAT: Deficiti tregtar 25 mld lekë, ulet me 6,9%

Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave, në muajin Qershor 2015 eksportet e mallrave arritën vlerën 24 mld lekë, duke u rritur me 5,8 % në krahasim me Qershor 2014 dhe duke u ulur me 1,2 % në krahasim me Maj 2015. Importet e mallrave në muajin Qershor 2015 arritën vlerën 49 mld lekë, duke u ulur me 1,1 % në krahasim me Qershor 2014 dhe duke u rritur me 10,0 % në krahasim me Maj 2015. Deficiti tregtar i këtij muaji është 25 mld lekë, duke u ulur me 6,9 % krahasuar me Qershor 2014 dhe duke u rritur me 23,3 % në krahasim me Maj 2015. Rritja vjetore e eksporteve prej 5,8 % këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: "Ushqime, pije, duhan" kanë kontribuar me +3,7 pikë përqindje, "Tekstile dhe këpucë" me +2,8 pikë përqindje, "Makinë, pajisje dhe pjesë këmbimi" me +0,8 pikë përqindje, "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me -3,1 pikë përqindje, "Prodime druri dhe letre" kanë kontribuar me -0,1 pikë përqindje.

### VENDET PARTNERE

Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 67,6 % të gjithë tregtisë. Në Qershor 2015, eksportet drejt vendeve




### BE

Shkëmbimet tregtare me BE zënë 67,6 % të gjithë tregtisë. Në Qershor 2015, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,2 % të totalit të eksporteve dhe importet nga vendet e BE-së zënë 64,8 % të totalit të importeve.

të BE-së zënë 73,2 % të totalit të eksporteve dhe importet nga vendet e BE-së zënë 64,8 % të totalit të importeve. Partnerët kryesorë tregtarë janë

Italia (34,8 %), Greqia (7,6%), Turqia (5,8 %) dhe Kina (5,4 %). Në muajin Qershor 2015, vendet e me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Qershor 2014 janë: Kosova me 32,2 %, Spanja me 31,4 % dhe Greqia me 11,5 %. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia me 9,6 %, Gjermania me 7,2 % dhe Malta me 5,7 %. Në muajin Qershor 2015, vendet e me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Qershor 2014 janë: Kina me 13,3 %, Greqia me 7,2 % dhe Italia me 1,7 %.



## VNALB112015

ALBCHROME SHPK IS LOOKING FOR A LOCAL ADMINISTRATOR WHO WILL WORK FULL-TIME AT THE FERROCHROME PLANT OF BURREL

**Summary**  
The role is a key strategic and administrative management position and has overall accountability for the smooth day-to-day running of the Burrel Ferrochrome Plant operations, as well as ensuring the compliance to and implementation of the legal framework in general and health and safety regulations in particular.

**Duties and Responsibilities**  
This position is responsible for the overall development, design, implementation, and execution of cost saving, administrative, logistical and operational processes.

**Primary Responsibilities:**

1. Responsible for Plant Operation, Profitability, Commercial Activities, etc;
2. Develop or/and implement in place regulations, policies, procedures and programs applicable to the plant function and act as liaison with other agencies & organizations assisting or regulating FeCr Plant activity as well as state institutions;
3. Improve plant operating performance; reduce waste and delays; promote cost reductions; and achieve a high level of operating efficiency;
4. Maintain a safe and efficient work environment;
5. Implement strict measures in operating procedures to optimize resource/capacity utilization;
6. Authorize planned preventive maintenance schedules of various machineries and instruments to increase machine up time and equipment reliability;
7. Proactively identify areas of obstruction/breakdowns and take steps to rectify the equipments through application of trouble shooting tools;
8. Assess the training needs of the various employees in co-ordination with the various operational department heads and HR.

**Qualifications and Skills**

- \* **Education:** Bachelor Degree in Business Management/ Accounting / MBA is highly desirable.
- \* **Work experience:** Minimum 10 years of managerial experience, with 5 – 7 years in a senior leadership role.
- \* **Skills & abilities:** Strong interpersonal & coaching skills; ability to communicate and manage well at all levels of the organization; Proven budgetary skills, cost control and effective reporting skills; Business development skills; Strong problem solving and creative skills and the ability to exercise sound judgment and make decisions based on accurate and timely analyses; High level of integrity and dependability with a strong sense of urgency and results-orientation; Demonstrated commitment to safe working practices; English fluency and PC proficiency

**Commuting Benefits:**

- The successful candidate must stay/live at least six days a week in Burrel (Monday to Saturday);
- An apartment will be provided by the company;
- A company car will be part of the benefits of the position

**Application Procedure:**  
To apply for this position, please submit all documents as requested below before 11.08.2015:

- Detailed CV;
- Cover Letter;

to AlbChrome HQ through one of the following ways:  
1.Via E-mail: hr@albchrome.al  
2.By Post at this address:  
Albchrome Sh.PK  
Rr. Budi, Classic Construction kati II,  
Tiranë, Shqipëri

# Si ndërpritet kompensimi i energjisë kur fillon punë fëmija

## Deklaratë kur fëmija fillon punë. Heqja pas lidhjes së sistemit me zyrat e punës

**DRIÇIM ÇAKA**  
TIRANË

Në rastet kur fëmijët e pensionistëve që marrin kompensimin e energjisë elektrike prej 648 lekësh, fillojnë punë, atëherë ky përfundim ndërpritet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Sipas të dhënave nga Drejtoria Rajonale e ISSH-s në Tiranë ka një numër të lartë të përfituesve të cilët pavarësisht se fëmija ka filluar punë, nuk kanë e kanë deklaruar këtë ndryshim. Vendimi qeverisë për mbrojtjen e shtresave në nevojë pas ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike përcakton se kur fëmijët janë në punë nuk përfitohet ky kompensim. Kur kompensimi është lidhur nga ISSH-ja dhe njëri nga fëmijët fillon punë, të moshuarit duhet

**ISSH**

### "Ata që nuk kanë përfutuar të dorëzojnë dokumentet"



Pensionistët, invalidët, kryefamiljarët me pagë nën 35 mijë lekë në muaj dhe familjet me ndihmë ekonomike që nuk kanë përfutuar kompensimin 648 lekë, duhet të dorëzojnë dokumentet. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thotë se çdo person që duhet ti jepet ky përfutim, do ta marrë në bazë dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave. Ndryshimi i vetëm do të jetë se përfutimi 648 lekë do të jepet nga data kur dorëzohen dokumentet, pasi ka përfunduar afati për të marrë përfutimin e të gjithë muajve. Sipas të dhënave të ISSH-s, ka një numër të lartë personash që edhe pse e përfutit nuk kanë dorëzuar dokumentet.



### HEQJA

Edhe kur kompensimi është lidhur nga ISSH-ja dhe njëri nga fëmijët fillon punë, të moshuarit duhet të deklarohen këtë ndryshim në të kundërt drejtoritë rajonale u heqin vet përfutimin prej 648 lekësh

### RIPËRFITIMI

ISSH bën me dije se kur fëmija fillon punë, nuk bëhet dorëzimi i asnjë dokumenti, por vetëm plotësimi i një deklarate. Gjithashtu ISSH ka përcaktuar se kompensimi mund ti rrijet pensionistit

të deklarohen këtë ndryshim në të kundërt drejtoritë rajonale u heqin vet përfutimin prej 648 lekësh. Kjo bëhet falë lidhjes së sistemit të ISSH me atë të Zyrave të Punës, për të verifikuar çdo rast kur kompensimi i energjisë përfutohet në mënyrë abuzive. Vetëm në muajt e fundit janë më shumë se 1000 raste kur kompensimi i energjisë është ndërprerë për faktin se fëmijët e të moshuarve fillojnë punë. ISSH bën me dije se kur fëmija fillon punë, nuk bëhet dorëzimi i asnjë dokumenti, por vetëm plotësimi i një deklarate. Gjithashtu, ISSH ka përcaktuar se kompensimi mund ti rrijet pensionistit nëse fëmijët ndërpresin marrëdhënien e punës. Ky rregull vlen edhe invalidët që marrin 648 lekë në muaj, të papunët me pagë nën 35 mijë lekë dhe për familjet që përfutit ndihmë ekonomike.

### PËRFITUESIT


Me mbarimin e afatit që kishte përcaktuar qeveria, pensionistët dhe shtresat e tjera në nevojë nuk mund të përfutit kompensimin duke filluar nga data 1 shkurt 2015. Përfutimi

**"Deklaratë, fotokopje e kartës së energjisë elektrike librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara"**

648 lekë, do të merret nga data që do të dorëzohen dokumentet. "Pensionistët kryefamiljarë që përfutit pension plegerie ose pension invaliditeti që përfutit kompensimin e çmimit të energjisë elektrike për shkak të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 KWh, përcaktohet nga ISSH dhe strukturat

rajonale në varësi të tij, bëhet bazuar në deklaratën personale të përfutituesit. Kryefamiljari pensionist/invalid i bashku me deklaratën, duhet të paraqesin pranë agjencive lokale: Fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit, certifikatën familjare për invalidët dhe fotokopjen e librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara. ISSH-ja bazuar në listat e përfutituesve harton pasqyrat përmblidhëse të kompensimeve, të detajuar sipas muajve për çdo drejtori rajonale në bazë qarqesh dhe paraqet kërkesën për fonde për financimin e pagesave pranë MMSR-së", - përcakton vendimi i qeverisë.

## LAJME SHKURT



### Gjermania nis kthimin e refugjatëve në Shqipëri

Shqipëria, Mali i Zi dhe Kosova janë klasifikuar si vende të sigurta të origjinës me kërkesë të Zyrës Federale për Migracionin dhe Refugjatët në Gjermani. Kjo është bërë me synimin e procedimit të shpejtë të refugjatëve nga vendet e Ballkanit, të cilët kërkojnë azil ekonomik në Gjermani. Kjo do të thotë se çdo kërkesë për azil nga refugjatët nga këto tre vende tashmë do të cilësohet si e pabazuar dhe do të lejohet vetëm në disa raste të veçanta. Në kuadrin e përkthimit dhe përshtetjes në atdhe të azilkërkuesve shqiptarë, sot do të mbërrijë në aeroportin e Tiranës një avion charter nga Kassel me 70 persona.

### Prishja e ndërtimeve për Unazën e Madhe, romët: Selektive

Prej disa ditësh, Inspektorati Kombëtar ka nisur prishjen e ndërtimeve në zonën e Fabrikës së miellit në kryeqytet për ndërtimin e unazës së madhe. Banorët romë të kësaj zone, të cilët janë prekur nga prishja e ndërtimeve shprehen të revoltuar, teksa thonë se janë bërë selektive gjatë prishjeve në dëm të komunitetit rom. Një nga shqetësimet madhore që kishin këta banorë ishte dhe ai se nuk do të mund të gjejnë më një vend për të jetuar bashkë me familjet e tyre.



### Aplikimi për kërkim nafte dhe gazi në Vlorë deri më 15 tetor

Dorëzimi i aplikimeve nga kompani të huaja për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure në zonën për kërkim nafte dhe gazi, Blloku 5 dhe Blloku Panaja në rrethin e Vlorës do të ketë afat deri më 15 tetor, ndërsa për kërkime në blloqet detare për shkak të konsolidimit të të dhënave sizmike, do të shtyhen për një afat tjetër. Dy kompani, nga më të mëdhatë në botë për kërkim nafte dhe gazi, "Shell" dhe "Delek" aplikuan deri më 15 Korrik pranë AKBN-së për të marrë me Marrëveshje Hidrokarbure zona për kërkim nafte dhe gazi, Bllokun 4 dhe Dumrenë.

### BSH: 22 IFJB rritën totalin e aktiveve 7,36% në vitin 2014

Në Shqipëri u numëruan 22 institucione financiare jobanka deri në fund të 2014, bëri të ditur BSH, në raportin e publikuar së fundi mbi Mbikqyrjen Bankare. Sipas veprimtarive financiare për të cilat janë licencuar, këto institucione në dhjetor 2014, arritën një total të aktiveve në vlerën e 32.23 miliardë lekëve, duke përbërë 2.5% të totalit të aktiveve të sistemit bankar. Krahasuar me vitin paraardhës, aktivet e subjekteve financiare jobanka gjatë 2014-ës, kanë shënuar një rritje të konsiderueshme prej 2.21 miliardë lekësh ose 7.36%.

### Tiranë, divorcet në rritje: Çdo ditë ndahen 5 çifte

Çdo ditë në kryeqytet, 5 çifte të martuarish divorcohen. Sipas statistikave të Gjykatës së Tiranës për 6-mujorin e parë të 2015-ës, ka një rritje të kërkesave për zgjidhje martesë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Përgjatë Janar-Qershor 2015, në Gjykatën e Tiranës janë paraqitur

2400 kërkesa për zgjidhje martesë ku 702 prej tyre kanë përfunduar me divorc. Numrin më të madh të padive e deponojnë bashkëshortet, të cilat në 70% të rasteve shprehin si shkak dhunën në familje e veset e bashkëshortit. Divorcet janë shtuar edhe në Durrës, Fier, Korçë, Elbasan dhe Shkodër.



### Fotografimi ajror, Harito: Projekti mbyllet këtë vit

Në Shqipëri u numëruan 22 institucione financiare jobanka deri në fund të 2014, bëri të ditur BSH, në raportin e publikuar së fundi mbi Mbikqyrjen Bankare. Sipas veprimtarive financiare për të cilat janë licencuar, këto institucione në dhjetor 2014, arritën një total të aktiveve në

vlerën e 32.23 miliardë lekëve, duke përbërë 2.5% të totalit të aktiveve të sistemit bankar. Krahasuar me vitin paraardhës, aktivet e subjekteve financiare jobanka gjatë 2014-ës, kanë shënuar një rritje të konsiderueshme prej 2.21 miliardë lekësh ose 7.36%.



# Formulari A2, ja degët ku pritet të rritet niveli i pikëve

## Ndryshimi i kuotave sjell dhe ndryshimin e nivelit të pikëve për disa degë

**DRIÇIM ÇAKA**  
TIRANE

Në degët si Mjekësia, Biologjia, Inxhinieria e Ndërtimit apo gjuhët e huaja pritet të rritet niveli i pikëve të fituesit të fundit. Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton se të gjitha këto degë do të kenë më pak kuota se një vit më parë dhe kjo do të thotë se gara pritet të jetë më e fortë mes maturantëve. Mjekësi nga 300 kuota që ka patur një vit më parë, do të ketë 240, Biologjia nga 120 do të ketë 100, anglishtja ka 20 kuota më pak, Inxhinieria e Ndërtimit dhe Stomatologjia 5 pranimet më pak si dhe gjuhët e huaja nga 10-15 kuota më pak. Përveç degëve që do të rritet niveli i pikëve, për ato degë që ka rritje të kuotave të pranimit, niveli i pikëve të fituesit të fundit pritet të ulet. Degët si Matematika, Shkenca Politike, Kimia dhe Arkeologjia do të kenë më shumë kuota për vitin akademik 2015-2016. Të gjithë kandidatët, sipas Ministrisë së Arsimit duhet të marrin parasysh faktin se në degët që kuotat janë ulur, gara do të jetë më e fortë dhe e kundërta për



degët që janë shtuar kuotat.

**FORMULARI**  
Sot është dita e fundit për

të gjithë maturantët e qarkut të Tiranës të plotësojnë formularin A2. Deri tani kanë aplikuar pjesë më e madhe

e kandidatëve. Sipas Agjencisë Kombëtare të Provimave më shumë se 60% e maturantëve kanë zgjedhur 10 degët me të cilat do të konkurrojnë në Universitet. Nga dita e nesërme do të nis plotësimi edhe në rrethet e tjera dhe maturantët e çdo qyteti do të kenë vetëm 1 ditë kohë për të plotësuar formularin A2. Aplikimi do të përfundojë në datën 4 gusht. Edhe këtë vit Agjencia Kombëtare e Provimave ka përcaktuar se do të ketë një mundësi për ata që gabojnë me përzgjedhjen e degëve, nëpërmjet formularit të korigjimit të pasaktësive. Pas përfundimit të aplikimeve do të publikohet Libri i Transparencës ku do të jenë të

### SI PRITET TË NDRYSHOJE NIVELI I PIKËVE

Degët që pritet të rritet pikët e fituesit të fundit

	Ishin (kuotat)	Bëhen (kuotat)	Pikët e fituesit të fundit 1 vit më parë
■ Mjekësi	300	240	6570.62
■ Biologji	120	100	5429.26
■ Anglisht	200	180	5320.26
■ Inxhinieria e Ndërtimi	120	115	6137.32
■ Stomatologjia	60	55	6549.47
■ Gjuhë Frëngë	120	110	4824.94
■ Gjuhë Gjermane	125	110	4834.68
■ Gjuhë Italiane	125	110	4926.35

Degët që pritet të ulet niveli i pikëve

	Ishin	Bëhen	
■ Matematikë	80	90	6134.71
■ Shkenca Politike	80	100	5523.52
■ Kimi	80	90	5148.35
■ Arkeologji	40	45	5061.92

renditura pikët sipas degëve që kanë zgjedhur kandidatët. Sipas Agjencisë Kombëtare të Provimave, pavarësisht se formulari A2 është plotësuar më vonë se një vit më parë, fituesit paraprak në universitete do të publikohet në

fillim të muajit shtator. Këtë vit do të jenë dhe dy faza të tjera, ajo e fituesve përfundimtar, ku do të hiqen nga listat kandidatët që nuk janë regjistruar dhe formulari A3, që do të publikohet për degët që ka kuota të paplotësuara.



REPUBLIC OF ALBANIA

## MINISTRY OF TRANSPORT AND INFRASTRUCTURE GENERAL DIRECTORATE FOR WATER SUPPLY AND SANITATION

### REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (CONSULTING SERVICES- FIRMS SELECTION)

Republic of Albania  
Ministry of Transport and Infrastructure  
General Directorate for Water Supply and Sanitation  
Water Sector Investment Project  
Loan No. IBRD-83230

**Assignment Title:** Consultancy Services for Geographical Information System (GIS) system for Durrës Water Utility  
**Reference No.:** CsD5

This request for expressions of interest follows the General Procurement Notice for this project that appeared in Development Business online No. WB 183-01/13 of January 14, 2013.

The Republic of Albania has received a loan from the World Bank toward the cost of the Albania Water Sector Investment Project (AWSIP), and intends to apply part of the proceeds of the Loan for consulting services for the GIS system for the Durrës Water Utility (DWU).

The objective of this consultancy is to give DWU the possibility to have a GIS system, with a user friendly interface, through which they can improve operational, reporting, and decision making activities.

The GIS system integrated with the current enterprise resource platform (ERP) will give a powerful tool to DWU in order to add another dimension to their current analysis which is the geographical location of their assets, customers, and meters. At the same time it will be much easier to have accurate geographical information any time works and changes are done to the assets wherever they are through mobile devices.

The project, through the implementation of specific application solutions, aims to achieve the following objectives:

- 1- Improve the knowledge of the Water Supply and Sewerage Network.
- 2- Adopt a GIS system for asset management (AM-GIS);
- 3- Integrate a GIS management with the ERP;
- 4- Include the flow meters and the water meters into the GIS system with the purpose to put them in relationship
- 5- Implementation of operational procedure with the purpose of dynamically update the GIS database by:
  - a. Update the database based on ordinary activity of DWU (ex: water network maintenance,

installation of new meters, water network expansion and/or modification)

- b. Update the database based on extraordinary activity of DWU (ex: field supervision with the exact purpose to gather missing information)
- 6- Adopt all offices of a geographical consultation system integrated in the database (GeoWater), that also support the operative procedure.
- 7- Adopt a geographic system that supports taking decision (GeoDSS) for analyzing data, producing reports that support the identification of areas with most unbalanced hydric situation

The implementation period will be approximately 90 days from contract signing.

The Ministry of Transport and Infrastructure now invites eligible consulting firms ("Consultants") to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services. The shortlisting criteria are:

- (i) general qualifications of the Consultant (10 points),
- (ii) description of similar assignments, experience in similar conditions (60 points); and
- (iii) availability of appropriate skills among staff (30 points).

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers dated January 2011 ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

Consultants may associate with other firms in the form of a joint venture or a sub-consultancy to enhance their qualifications.

A Consultant will be selected in accordance with the CQ method set out in the Consultant Guidelines. Further information can be obtained at the address below during office hours 08.00 to 16.30 hours from Monday to Thursday and 08.30 to 14.00 on Friday.

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by fax, or by e-mail) until **August 14, 2015**.

General Directorate for Water Supply and Sanitation  
Attn: Mr. Ardian Alushi, General Director  
with a copy to: Mr. Indrit Shamata, PIU Director  
Address: Lajço 4, Rruga "Sami Frashëri" Tirana, Albania  
Tel: +355 4 2256091  
Fax: +355 4 2256091  
E-mail: ardi.alushi@hotmail.com  
CC: indritshamata@yahoo.com

# Ish-guvernatori Fullani nën akuzë për "Dajtin" e vjedhjen e bankës

## Ish-numri një i BSH merret i pandehur për akuzën e "Shpërdorimit të detyrës"



Ardian Fullani

ELTON QYNO  
TIRANE

Ish-guvernatori i Bankës së Shqipërisë Adrian Fullani nga kjo e martë është zyrtarisht nën akuzë për "Shpërdorim detyre". Fullani është njohur me akuzën ndaj tij rreth orë 16:00 në zyrën e prokurorit Ndini Tavani ku ish-zyrtari i bankës ka qenë në shoqërinë e avokatit të tij Maks Haxhia. Hetimet për Fullanin u mbyllën një vit pas skandalit të vjedhjes së 713 milionë lekëve në Thesarin e Bankës si dhe verifikimit të tenderit të blerjes së Hotel "Dajtit" dhe tenderave të qirasë për objekte të marra në shfrytëzim nga Banka e Shqipërisë. Burimet bëjnë me dije se Fullani nuk ka kundërvetur konkluzionet e akuzës, por ka firmosur mbylljen e hetimeve duke pretenduar pajtësinë e tij. Të njëjta burime sqaruan se në hetimet e kryera një ndër provat që ka faktuar "shpërdorimin e detyrës" nga ish-guvernatori është fakti se procedurat e tenderit për blerjen e Hotel "Dajtit" kanë nisur një muaj pasi qeveria e drejtuar nga ish-kryeministri Berisha kish shpallur me vendim shitjen e hotelit për llogari të bankës. Dëmi në buxhetin e shtetit për llogaritë në miliona euro. Ndërkohë në shtator pritet të hapet procesi gjyqësor kundër tij.



Godina e Hotel Dajtit



Ardian Bitraj duke vjedhur

### 5 GABIMET

Për vjedhjen e shumës së 713 milion lekëve nga banka e Shqipërisë prokuroria e akuzon Ardian Fullanin se ka shkelur ligjin në pesë raste duke mos parandaluar vjedhjen.

partamentit të Emisionit, ku ka ndodhur edhe vjedhja, Këshilli Mbikqyrës duhet të propozonte e miratonte rregulloret përkatëse për funksionimin e këtij departamenti. Nga hetimi ka rezultuar se këto rregullore nuk kanë ekzistuar për një kohë shumë të gjatë, gjë e cila ka sjellë cenimin e parave.

**SË TRETË:** Në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv të Bankës së Shqipërisë, nuk ka marrë masat e nevojshme ligjore për zbatimin e vendimeve dhe rregullore të Këshillit Mbikqyrës. Ndër to, mund të përmendet zbatimi i politikave të miratuara nga Këshilli Mbikqyrës, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme për administrimin e procedurave ekzekutive, si dhe për qeverisjen e punëve administrative të veprimtarisë së Bankës së

Shqipërisë.

**SË KATËRTI:** Guvernatori është i ngarkuar me mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të Bankës së Shqipërisë, përgjegjësi të cilën nga analiza e hetimit në kuadër të procedimit penal, rezultoi që nuk e ka ushtruar.

**SË PESTI:** Në kundërshtim me nenin 8 të rregullores "Mbi inventarizimin e vlerave materiale e monetare në Bankën e Shqipërisë". Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, në komisionet e ngritura për kryerjen e inventarizimit të detyrueshëm periodik të vlerave monetare në Bankën e Shqipërisë ka caktuar dy herë të njëjtin person. Ky person, aktualisht është person në hetim për "shpërdorim detyre" në kuadër të këtij procedimi penal.

### SHKELJET E FULLANIT

**SË PARI:** Nuk i ka propozuar Këshillit Mbikqyrës, zëvendësguvernatorin e dytë të Bankës së Shqipërisë, duke krijuar një boshllëk në përmbylljen e detyrimeve të këtij funksioni. Duhet theksuar se

ky funksion i munguar duhet të trajtonte drejtëpërdrejt administrimin, mbikqyrjen dhe zbatimin e akteve procedurale për përdorimin e mjeteve financiare.

**SË DYTË:** Në cilësinë e kryetarit të Këshillit Mbikqyrës,

nuk ka ushtruar kompetencat e tij për propozimin e nis-mave juridike të funksionimit të Bankës së Shqipërisë, si detyrim që buron nga vendimi i Këshillit Mbikqyrës Nr.13 datë 22.02.2006. Pra me nisjen e funksionimit të de-

## LAJME SHKURT



### Shkodër, makina përplas çiftin e moshuar, largohet autori

Një çift bashkëshortësh janë plagosur rëndë si pasojë e një aksidenti që ndodhi në unazën lindore të Shkodrës. I moshuari 70-vjeçar dhe bashkëshortja e tij 60 vjeç po udhëtonin me një motorçikletë në zonën e stacionit të trenit, kur janë përplasur nga një automjet tip "Fiat". Përplasja ka spostuar disa metra çiftin e bashkëshortëve, ndërsa drejtuesi i automjetit është larguar në këmbë nga vendi i ngjarjes. Të moshuarit ndodhen në spital në gjendje kritike, ndërsa policia po punon për kapjen e drejtuesit të mjetit.

### Vlorë, kapet 23-vjeçari, fshehu drogë në autobus

Një 23-vjeçar u arrestua nga policia e Vlorës pasi kishte fshehur 2.5 kilogramë kanabis brenda sedijes së autobusit Vlorë-Siçili me të cilin udhëtonte drejt Italisë. Blutë e Vlorës arrestuan Julian Hoxharën, pasi gjatë kontrollit në autobus në brendësi të sediljeve të fundit u gjetën dhe sekustruan 5 pako të mbështjella me qese telefoni me lëndë narkotike brenda. Sipas policisë, i riu e kishte transportuar lëndën narkotike me makinën e tij dhe më tej e kishte fshehur në autobus për ta trafikuar drejt Italisë.



### Tiranë, i gjetet automatik, vihet në pranga

Një 35-vjeçar i cili lëvizte me një automatik në makinën e tij është arrestuar nga ana e policisë së kryeqytetit. Efektivët e komisarariatit nr 3 kanë gjetur armën e zjarrit automatik model 56 me një krehër me fishekë të fshehur në automjetin e 35-vjeçarit Kristi Bala, gjatë kontrollit në zonën pranë rrugës së barrikadave. Pas vënies në pranga të 35-vjeçarit policia ka nisur hetimet për verifikimin nëse arma është përdorur në krime të tjera, por edhe nëse Bala do ta përdorte armën për donjë krim të mundshëm në të ardhmen.

### Vdekja e minatorit, në pranga përgjegjësi

Një ditë pas vdekjes së minatorit në Bulqizë policia e Dibërës ka arrestuar Saimir Kolecin, me detyrë përgjegjës në sektorin elektrovizit për akuzën e shkeljes së rregullave në punë. 52-vjeçari Mehmet Dardha, humbi jetën ditën e hënë brenda galerisë në zonën D. Shkak i aksidentit të rëndë është bërë një defekt teknik i dy vagonëve që janë shkëputur, të cilin viktimja është përpjekur ta rregullojë. Sipas hetimeve paraprake është nxjerrë konkluzioni se mungesa e kushteve të përshtatshme në galerinë 1050 kanë sjellë dhe vdekjen e minatorit.




### Elbasan, nën hetim 42-vjeçarja, ushtroi dhunë ndaj noteres

Një grua 42-vjeçare po procedohet penalisht nga Prokuroria e Elbasanit, me akuzën e dhunës fizike ndaj personave të tjerë. Autoritetet lokale njoftojnë se, 42-vjeçarja me inicialet E.I ka goditur me sende të forta një grua tjetër, banuese në Gramsh, e cila punon si notere. Të njëjtat burime shtojnë se prokuroria e rrethit ka ngritur ndaj saj akuzën për kryerjen e veprës penale goditje për shkak të detyrës. Ndërkohë, gruaja e dhunuar, me profesion notere është identifikuar me inicialet G.H. 41 vjeçe.

### Tentoi të korruponte efektivin e rrugores, pranga të riut

Një i ri është vënë në pranga nga policia, e cila e akuzon se ka tentuar që të korruptojë një efektiv të rrugores. Klodian Tana është ndaluar në vendin e njohur si rreth-rrutullimi i Mulletit, në dalje të segmentit të autostradës Elbasan-Tiranë. Sipas të dhënave nga policia ndalimi i tij është bërë për shkak se automjeti i tij, një BMË X5 ishte me xhama të zinj. Policia tha se për të shmangur gjobën ai ka tentuar t'i japë një efektivi 3 mijë lekë të reja rryshfet. Pikërisht në këtë moment është bërë edhe arrestimi i të riut.





## Kuçovë, në kërkim i riu, përdhanoi një të mitur

Seksioni për Krime të Policinë e Beratit ka nisur procedim penal dhe ka shpallur në kërkim një 24-vjeçar. A.M., banues në Kuçovë dyshohet se ka kryer marrëdhënie seksuale me dhunë me shtetasen L.G, 14 vjeçe, banuese në Kuçovë. 24-vjeçari me këtë akuzë rrezikon 5-15 vjet burg. Materialet i kanë kaluar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat për veprën penale "Marrëdhënie seksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç".



## Pukë, priste pemët në pyll, dëmtohet rëndë 47-vjeçari

Në malin e Krrabit në Pukë, një 47-vjeçar është plagosur rëndë pasi e ka zënë pema poshtë. Mësohet se 47-vjeçari Tonin Çuni bashkë me djalin 14-vjeçar kanë shkuar për të prerë dru në Malin e Krrabit në mënyrë të paligjshme dhe një dru i ka shkakuar dëmtime të rënda. Menjëherë strukturat e emergjencave civile dhe ato shëndetësore kanë shkuar dhe e kanë transportuar me helikopter në Spitalin e Traumës në Tiranë.

## Mblidhet Këshilli i Prokurorisë për pronat

Këshilli i Prokurorisë ka zhvilluar dje me detyrë të mbyllura mbledhjen për të diskutuar rreth njësisë së hetimit të pronave të falsifikuara. Në mbledhjen e drejtuar nga kryeprokurori Adriatik Llalla është diskutuar edhe për ndryshimet që do të ndodhin në të gjitha prokuroritë në vend. Ajo që bëhet e ditur është fakti se në gjatë prokuroritë të vendit do të ketë ndryshime, por ende nuk dihet në mënyrë specifike se cilat do të jenë ato.

## GRABITJA

Persona të pa maskuar kanë thyer xhamat e banesave ku po pushonin dy deputetët e djathtë Arben Ristani dhe Flamur Noka



CELULARËT

Në banesat e grabitura dje në zonën e "Gjirit të Lalzit", janë marrë disa aparatë celularë. Mësohet se hajdutët kanë thyer xhamat e shtëpisë e pasi kanë marrë celularët janë larguar



10 MIJË LEKË

Një shumë prej 10 mijë lekë të vjetra është marrë dje në banesën ku po pushonin familjarët të deputetit Ristani. Po ashtu, përveç kësaj shume është marrë edhe një aparat celular i markës "Samsung"

## SENDET

# Grabiten banesat ku pushonin deputetët e PD e disa të tjera

## Hajdutët marrin disa telefona dhe 10 mijë lekë të vjetra

XHENSILA KODRA  
TIRANE

Dy banesa në "Gjirin e Lalzit" ku po kalonin pushimet dy deputetët të Partisë Demokratike kanë rënë pre e grabitjes mesnatën e 27 korrikut. Në një prej banesave ishte duke pushuar familja e Arben Ristanit dhe kunata e tij, e ndërsa tjetra është banesa e një miku të deputetit Flamur Noka, në të cilën ky i fundit kishte shkuar për të kaluar disa ditë pushimi. Burime nga Policia e Durrësit thanë se përveç këtyre dy banesave kanë qenë edhe disa të tjera të cilat kanë rënë pre e grabitjes. Mësohet se banesa ku po pushonte familja e deputetit Ristani ndodhet në ambientet e kompleksit "Lura", e cila është marrë në ruajtje nga roje të një kompanie private, për të cilët janë këta të fundit që do të mbajnë përgjegjësi për ngjarjen.


## NGJARJA

Ka qenë mesnatë kur persona ende të paidentifikuar nga policia kanë thyer xhamat dhe kanë hyrë në disa banesa në zonën e "Gjirit të Lalzit" dhe kanë marrë që aty disa aparate celularë e më pas janë larguar. Në një lidhje telefonike me deputetin e djathtë Flamur Noka tha për gazetën "Shqiptarja.com" se në momentin që hajdutët kanë hyrë në banesë, ai së bashku me të afërmit e tij nuk kanë konstatuar asnjë zhurmë dhe kanë kuptuar se kishin rënë pre e grabitjes vetëm kur janë zgjuar në mëngjes. Më tej, Noka tha se nga ambientet e shtëpisë ishin marrë vetëm telefona e mikut të tij. Ndërsa, në banesën ku ndodheshin gruaje e deputetit Ristani, kunata e tij, si edhe femijët ishte marrë vetëm një aparat celular i markës "Samsung", si edhe 10

## Ristani:

**Nuk ka pasur gjë për të vjedhur përveç ndonjë celulari**

Pas grabitjes së banesës ku ishte duke pushuar familja e Ristanit, ka qenë pikërisht ky i fundit i cili ka reaguar në rrjetin e tij social Facebook, ku shkruan: "Shtëpia ku po pushon gruaje dhe kunata ime, së bashku me femijët në Lalz, është vjedhur mbrëmë, ndërkohë që njerëzit flinin. Nuk ka pasur gjë për të vjedhur përveç ndonjë celulari. Do kisha thënë fatmirësisht dem i vogël, por ndërkohë janë vjedhur edhe disa shtëpi të tjera ku përveç demit, frika dhe trembja e njerëzve ka qenë e madhe. Kam denoncuar shpesh në emër të PD, se vjedhjet dhe grabitjet janë shtuar shumë dhe kjo është tregues i qartë jo vetëm i përmasave të varfërisë, por edhe i gjendjes mizerabel të rendit dhe sigurisë në vend. Më duhej edhe kjo që të kuptoja në lekuren time se si ndjehen njerëzit që ju përdhuhet jeta".



NË FOTO:

Faksimile e statusit në FB të Arben Ristanit



Arben Ristani



Flamur Noka

## Reagimi

**Noka: "Nuk kemi ndjerë asnjë zhurmë, ishim në gjumë"**

Deputeti i djathtë Flamur Noka, në një lidhje telefonike për gazetën "Shqiptarja.com" tha se kishte shkuar për të kaluar disa ditë pushimi në banesën e një mikut të tij i cili ndodhej në zonën e "Gjirit të Lalzit" kur kanë rënë pre e një grabitjeje. Ai tha se nuk kanë ndjerë asnjë lloj zhurme të hajdutëve pasi kanë qenë të gjithë në gjumë dhe në mëngjes kanë vënë re se në banesë ishin futur hajdutët. "Kam qenë në shtëpinë e një mikut tim që jeton në "Gjiri i Lalzit" për disa ditë të pushuar, por kur sot (dje) në mëngjes jemi zgjuar nga gjumi kemi konstatuar se në shtëpi kishin hyrë hajdutët. Nuk e di se sa persona mund të kenë qenë por në shtëpi ata kanë marrë vetëm telefona të cilët ishin të mikut tim. Nuk u grabitëm vetëm ne, por ishin edhe disa banesa të tjera dhe në një prej tyre kishin qenë familjarët e një kolegut tim".

mijë lekë të vjetra të cilat kishin qenë në kuzhinë.

## SEKUESTRIMI

Burime nga Policia e Durrësit thanë se në lidhje me

këtë ngjarje kanë marrë pamjet e kamerave të sigurisë së kompleksit "Lura" si edhe të disa bizneseve të tjera të cilat ndodhen aty pranë. Po ashtu, edhe për banesat e tjera të gra-

bitura janë sekuestruar edhe disa kamera të tjera sigurie, ku është konstatuar se hajdutët kanë qenë të pa maskuar dhe tashmë janë kërkim nga policia.

# Turku-polices: O bashkëjeto me mua, o do të vras fëmijët

## S' pranoi të vijonte lidhjen do vriste të dashurën police

ELTON QYNO  
TIRANË

Një efektive policie, nënë e dy fëmijëve i ka shpëtuar me kullishtë vdekjes, kjo pasi i dashuri i saj turk në përleshje e sipër, i ka rrembyer pistoletën e shërbitit dhe me të ka qëlluar tre herë, por fatmirësisht arma nuk ka qëlluar. Ngjarja ka ndodhur në 25 nëntor 2013 ku efektiva e policisë Nerejda Laze, pasi ka përfunduar detyrën e saj në turnin e dytë, po kthehej në banesë, ku me vehte kishte marrë dhe disa ushqime, për fëmijët e saj. Mirëpo teksa ecte ajo është përballur rreth orës 22:00 me shtetasin turk Mujdat Sayan, me të cilin kishte pasur një lidhje dashurie dhe më pas ishte ndarë. Shtetasi turk me anën e një thike e ka kërcënuar duke e detyruar që të shkonte e të bashkëjetonte me të, por efektiva e policisë e ka refuzuar. Pas kësaj ai ka ushruar forcë duke e kërcënuar dhe goditur me thikë ku si rezultat i kësaj i ka prerë gishtin. Për vetëmbrojtje, policia ka nxjerrë armën e shërbitit ku në përleshje e sipër, ish-i dashuri i ka marrë armën dhe me të ka qëlluar tre herë, por arma nuk është aktivizuar. Pas kësaj policia ka kërkuar ndihmë, ndërsa autori është larguar me makinë. Ai mundi të arrestohej dhe gjatë ditës së djeshme prokuroria ka kërkuar dënimin e tij me 27 vite burg për dy akuzat të rënda.

### O BASHKËJETO TË VRAS FËMIJËT

I pandehuri Mujdat Sayan prej disa kohësh është njohur e ka krijuar lidhje dashurore dhe ka bashkëjetuar me shtetasen Nerejda Laze. Ajo është punonjëse policie në Tiranë. Pasi janë ftohur marrëdhëniet midis tyre, shtetësja Laze i ka shkëputur lidhjet me shtetasin Mujdat Sayan. I pandehuri nuk e ka pranuar këtë ndarje, duke i bërë vazhdimisht presion shtetases Laze për të bashkëjetuar me të, madje disa herë ka ushtruar edhe dhunë fizike ndaj saj. Më datë 25.11.2013 shtetësja Laze ka qenë me shërbim turni i dytë nga ora 14.00 deri në ora 22.00. Gjatë kësaj periudhe kohore që ishte me shërbim, i pandehuri është takuar me shtetasen Nerejda Laze tek




Prokuroria e Krimeve të Rënda

### Konflikti

## Ingacmoi të dashurën policit dhe e plagosi me kaçavidë

Një efektive policie ka mbetur i plagosur pasi është qëlluar me një kaçavidë. I plagosur mbeti Jetnor Xhaferri i cili është punonjës në komisariatit numër 3, në Tiranë. Burime pranë këtij komisariati sqartuan se shkak i plagosjes së Xhaferrit ka qenë pikërisht e dashura e tij e cila ishte ulur në një "bar-kafe" në rrugën "Mine Peza". Ngjarja ndodhi dje rreth orës 14:00 kur e dashura e efektivit ka shkuar në një lokal pranë komisariatit numër 3 dhe aty është ngacmuar nga një 50 vjeçar, Agim Mataj. Ky i fundit pasi është konfliktuar me fjalë me efektivin Xhaferri ka nxjerrë një kaçavidë nga xhepi dhe e ka qëlluar atë. Sipas burimeve, mësohet se vajza, identiteti i së cilës nuk bëhet i ditur nga policia është shprehur se kjo nuk është hera e parë që ka pasur ngacmim nga ky person. Menjëherë pas ngjarjes, policia ka shkuar në lokal duke bërë të mundur edhe arrestimin e 50 vjeçarit Mataj. Gjatë kontrollit, këtij personi me vete iu gjet kaçavida me të cilën plagosi efektivin Xhaferri, e cila



menjëherë iu sekuestrua në cilësinë e provës materiale. Po ashtu, policia kontrolloi edhe banesën e tij në të cilën u gjet dhe sekuestrua edhe një armë gjahu. Lidhur me këtë ngjarje, policia është duke punuar për zbardhjen e plotë të ngjarjes, ndërsa Mataj akuzohet për veprën penale të "Plagosje e lehtë të punonjësit të policisë".

huri ka vazhduar duke i thënë "...o do të vras fëmijët me mua, ose do të vras ty e fëmijët e tu...".

### PËRPLASJA ME TURKUN

Shtetësja Laze ka mundur të shkëputet nga i pandehuri

e më vonë pas mbarimit të shërbimit në ora 22:10, pasi ka marrë në duar disa qeska me ushqime, perime e bukë, ka qenë duke shkuar për në shtëpi. Tek rr. "Bardhyl", i pandehuri i ka dalë përsëri dhe e ka kanosur përsëri që


ajo të bashkëjetonte me të. I pandehuri i ka vendosur një thikë në trup shtetases Laze tek pjesa e ijes, në fund të brinjëve dhe e ka shtyrë për tek autovetura e tij afër piceri "Hallall" tek koshat e plehrave. Më pas i pandehuri i vendos thikën në fyt, dhe i thotë: "...do të fus thikën po nuk erdhe të bashkëjetosh me mua...". Në këtë moment shtetësja Laze është përleshur me të pandehurin, nga ku i kanë rënë përtokë qeskat që mbante në duar, kapelja dhe mushamaja e policisë, si dhe është rrëzuar edhe vetë përtokë. Menjëherë shtetësja Laze ka nxjerrë pistoletën që mbante për shkak të detyrës, me qëllim që i pandehuri ia ka rrembyer pistoletën nga dora dhe e ka mbushur e rimbushur 2-3 herë, duke ja ka drejtuar shtetases Nerejda Laze, në pjesën e kokës por pa mundur të hapë zjarr me të.

### PRERJA E GISHTIT

"Në momentin që u ktheva tek piceria, zotëria filloi e donte të më merrte zvarrë, "...do vish me makinë tani...", dhe më tërhiqte zvarrë. Në momentin që po më tërhiqte, donte të më kapte më fort këtu dhe në një moment, u lëshua dhe unë rashë, megjithë qeskat si kisha. Rashë sepse duke tërhequr në një moment më la bosh dhe iku trupi, u batua. Rashë në shesh në një moment, lashë edhe qeskat. Në moment që rashë në shesh, më erdhi sipër si egërsirë, thikën e kishte në dorë dhe në moment donte të më priste këtu, dhe unë vura dorë, fati im që vura gishtin dhe u pre gishtin. Në momentin që unë ndjeva gishtin isha e detyruar, të nixrja armën, sepse mua mu cënua jeta, isha e vdekur" - ka treguar policia në gjykatë.

### ARMËN QË E MBAJE PËR SHKAK TË DETYRËS?

Për shkak të detyrës, se unë kthehesha nga puna, nuk është se unë kisha gjëra të përgatitura. Në momentin që unë nxorra armën, zotëria ishte lart. E mora armën për ta trembur, as e mbusha. Në momentin që e kapa lart, zotëria e kapi nga lart armën dhe nuk ma linte domethënë që ta posedonte dhe e mori në një mënyrë se ishte lart, sepse kishte pozicionin e tillë dhe e kapi kshu dhe e mori në dorë. Në momentin që e mori në dorë, unë jam shokuar komplet sepse ma drejtoi armën. E ka rimbushur dy - tre herë, në atë kohë kam bërtitur. Pashë si një vegim të interneti që dolën çunat dhe u futën



### Kërcënimi

"...shiko terezinë tënde, se unë kam probleme me fëmijët...". por i pandehuri ka vazhduar duke i thënë "...o do të vish të bashkëjetosh me mua, ose do të vras ty e fëmijët e tu...".



### Jam policia

E pashë vetëm si vegim, iku këshu si ushtarak me pistoletën dhe atyre çunave të internetit ju ka thënë vetëm kaq. "...largohu se jam policia..." dhe ka iku drejt makinës megjithë armën.



### Përtjetimi

Isha shokuar sa më ngrinë duart, isha në gjendje tmerri, mendova vetëm fëmijët e mi që ngelën vetëm, asnjë gjë tjetër, dhe kur kam hapur sytë jam habitur si nuk isha vrasarë.

prapë brenda se panë armën.

**E dëgjove mbushjen? Po, ma drejtoi në fytyrë. Ishte sipër.**

**E shkrepja ishte, se s'mori fishek.**


**Çu bë më pas?**

Më pas pashë si vegim vetëm zotërinë, kur hapa sytë nuk e mendova se isha gjallë, sepse thashë nuk dëgjova krimë, se krima normale do të isha zhdukur, ishte shumë afër. E pashë vetëm si vegim, iku këshu si ushtarak me pistoletën dhe atyre çunave të internetit ju ka thënë vetëm kaq. "...largohu se jam policia..." dhe ka iku drejt makinës megjithë armën.



# Eksperiment me lazer akuza nuk gjen predhën

## Vrasja e efektivit të RENE A, Prokurorë e policë zbarkojnë sërish në Lazarat për drejtimin e qitjes



PERLAT HAMITAJ

Efektivi i RENE A ka qenë së bashku me Ibrahim Bashën në makinën që u sulmua me armë në Lazarat. Hamitaj gjatë këtij sulmi ka marrë një plagë të lehtë ndërkohë që tashmë rezulton jashtë rrezikut për jetën.




JETMIR ISA

Oficeri i RENE A ndodhej brenda në furgon kur është sulmuar menjëherë me armë. Ai ka marrë një të gërvishur të lehtë në kokë, duke arritur të shpëtojë mrekullisht nga vdekja.



Vendi ku u ekzekutua oficeri i RENE A Ibrahim Basha



Ibrahim Basha

të të rinjë të Lazaratit për të sulmuar policinë dhe janë ata që kanë grumbulluar rreth vetes rreth 17 persona. Burimet thanë se është provuar tashmë se sulmi ishte planifikuar disa muaj më parë, me takimet e herëpashershme me tyre, mbledhjen e armëve, ndarjen e detrave për gjithësecilin, përgatitja dhe qepja e maskave të kokës tek një rrobqepëse në fshat, prishja e murit rrethues dhe ndërtimi i pozicioneve sulmuese. Hetuesit thonë se edhe ditën e sulmit me armë, janë Arbion Aliko dhe Bajram Boci personat që kanë dhënë urdhrin për të qëlluar në drejtim të policisë.

imtësi nëpërmjet një aparati metal kërkues predhën që i morri jetën efektivit të policisë Ibrahim Basha. Vendngjarja është kontrolluar disa herë me aparatën metal kërkues, por sërish kërkimet kanë dalë pa rezultat. Burime pranë prokurorisë thanë se gjatë ditës së djeshme nuk është bërë e mundur gjetja e predhës, dhe kjo për ta është kthyer tashmë në një mision të pamundur. Sipas tyre edhe nëse predha do

të gjendet ajo besohet të jetë e dëmtuar dhe për pasojë nuk do ketë elementë përbërës për identifikimin e saj.

### GJURMËT E GISHTAVE

Nga ana tjetër ende nuk kanë përfunduar ekzaminimet e gjurmëve të gishtave në armët e Lazaratit, për t'i krahasuar me gjurmët e gishtave të të arrestuarve. Të dyshuarit për sulmin me armë ndaj policisë, ku mbeti

i vrarë efektivi i RENE A Ibrahim Basha, do të mbajnë përgjegjësi penale edhe për akuzën e grupit të strukturuar kriminal. Krahas akuzës së vrasjes në rrethana cilësuese ndaj punonjësit të policisë, në ngarkim të të dyshuarve si grupi i zjarrit ngre akuzën edhe të grupit të strukturuar kriminal. Sipas prokurorisë, Arbion Aliko dhe Bajram Boci, i shpallur në kërkim, dyshohet se janë ideatorët e organizimit


### ELTON QYNO TIRANE

Një paisje lazer lëshuese është përdorur nga Prokurorët e Krimeve të Rënda si armë, për të mësuar pozicionin dhe këndin se nga është qëlluar në drejtim të Ibrahim Bashës, oficerit të RENE A-s që mbeti i vdekur në fshatin Lazarat. Për gati dy orë me radhë, tre prokurorët Anton Martini, Besim Hadërmataj dhe Ervin Kondili të shoqëruar edhe nga specialistë të Policisë së Shtetit kanë kryer matjet e nevojshme, ndërkohë që ndryshe nga sa ishte planifikuar për marrjen e dy të penduarve të kësaj dosje në vendin e ngjarjes, kjo gjë nuk ka ndodhur. Kjo pasi mund të sillte tensionimin e situatës me banorë të zonës, dhe mund të sillte momente përplasjesh. Grupi hetimor ka kryer me kujdes të gjitha veprimet, të cilat më pas do analizohen edhe me dëshmitë e dhëna nga dy të arrestuarit që tashmë cilësuar si të penduar Klodian Selimi dhe Xhuliano Malo. Në riekspertimin e vendit të ngjarjes nuk pati qitje, por për të zbuluar vendin nga u godit me armë Ibrahim Basha u përdorur një aparat lazer. Ibrahim Basha u ekzekutua më 24 qershor tekta futej në Lazarat për një operacion policor. Aty u plagosen edhe dy kolegët e tij që ndodheshin në makinë.

### NË KËRKIM TË PREDHËS

Gjatë ditës djeshme grupi hetimor ka kontrolluar me

## LAJME SHKURT



### Kapen 5 trafikantë droge pas disa muajsh hetim

Pesë persona janë vënë në pranga nga Policia e Beratit në një operacion kundër trafikut të drogës. Në operacionin e koduar "Bullolli 2015", u arrestuan në flagrancë Vladimir Selenica, 47 vjeç, Mario Selamaj, 36 vjeç, Taro Ahmeti, 25 vjeç, Shpëtim Xhoxhaj, 35 vjeç dhe Paqësor Selenica, 25 vjeç. Policia u sekuestroi 6 thasë të mbushur me lëndë narkotike të dyshuar marjuaanë, me peshë rreth 20 kg, 2 automjete, 16 650 euro, 45,000 lekë të reja dhe 6 celularë. Si rezultat i hetimeve disa muore, dje, në fshatin Drobonik këta persona u arrestuan në flagrancë.

### Shkodër, iu gjetën armë në banesë, në pranga 46-vjeçari

Një person ka rënë ditën e djeshme në prangat e Policisë së Shkodrës. Bëhet fjalë për 46-vjeçarën Gëzim Çekaj, arrestimi i të cilit u bë pasi gjatë kontrollit në banesën e tij, efektivët e Policisë së Shkodrës gjetën armë dhe fishekë. Burime nga policia lokale bëjnë me dije se në shtëpinë e Gëzim Çekajt, 46 vjeç, u gjetën e u sekuestruan në cilësinë e provës materiale një pushkë, një automatik si dhe 80 fishekë. Materialet në ngarkim të të arrestuarit i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprën penale "mbajtje pa leje e armëve e municioneve luftarake".

### Vlorë, arrestohet anëtar i 8 i bandës kriminale, u merrnin para të panjohurve

Një 20-vjeçar nga Vlorë është arrestuar nga policia pasi me anë të mashtrimit kishte mundur t'i merrte shumën prej 50,000 mijë lekësh të reja një qytetari nga Beratit. Xhuliano Muçi i është paraqitur B.P. si i afërm i djalit të tij e i ka kërkuar t'i transferojë



50 mijë lekë të rinj, shumë të cilën e ka marrë kur ka ardhur në Shqipëri përmes një pike transfertash. 20-vjeçari është anëtar i tetë i një bande që drejtohej nga personi me iniciale Sh.N, të cilët siguronin kontakte me persona të ndryshëm dhe iu kërkoi para duke u shtirur si të afërm të tyre.



### Britani, kapet me drogë shqiptari: Jam me mision nga Interpoli

Një shqiptar i kapur nga policia britanike për shpërndarje droge deklaroi para tyre se ishte anëtar i Interpolit në një mision sekret për zbulimin e një rrjeti droge. Kilsman 50kajit iu gjetën me vete në momentin e arrestimit 7 gr. kokainë 2000 paund dhe 50 euro, ndërsa gjatë kontrollit në banesë iu gjetën 213 gr të tjera kokainë. Pas arrestimit të tij më 14 maj, ai u dënua së fundmi nga Gjykata e Nottinghamit me 3 vite burg për shpërndarje droge. Ndryshe nga çfarë u deklaroi policive para trupit gjyqësor ai pranoi se kishte gënjyer dhe se drogën do ta shiste vetë.

### Aksidenti në Milot-Rrëshen, 4 të plagosur në gjendje kritike



Ndonëse kanë marrë ndihmën e parë dhe shërbimin e specializuar në Spitalin e Traumës në kryeqytet katër prej 10 të aksidentuarve me makinë në aksin Milot-Rrëshen ndodhen ende në rrezik për jetën në sallat e reanimacionit. Tefik Zhurda, shefi i shërbimit të anestezi-reanimacionit në Spitalin e Traumës sqaron se situata e tyre është e rëndë dhe ata ndodhen në rrezik të madh për jetën. Katër të plagosurit mbërritën në Spitalin e Traumës mbërrimjen e së hënës pas një aksidenti në Rrugën e Kombit në aksin Milot-Rrëshen ku makinat e dy familjeve u përplasën me njëra-tjetrën.

### Gjendet makina që iu vodh kambistit, një hap pranë autorëve

Policia e Fushë-Krujës zbuloi në orët e vona të natës së të hënës makinën e grabitur të kambistit Cen Hyseni, ngjarje e ndodhur dy ditë më parë në afërsi të Rinasit. Burime policore thanë se mjeti tip BMW që iu mor me dhunë kambistit është gjetur i braktisur në afërsi të lumit

Tërkuzë në Nikël të Krujës. Sipas policisë makina ka qenë e padëmtuar dhe kjo do të jetë një provë e rëndësishme për të gjetur gjurmët e autorëve të grabitjes së 100 mijë eurove që Hyseni kishte me vete kur dy personat e armatosur i dolën përpara dhe e grabitën.



Punimet e pallatit që bllokoi Zyhdi Dajti

**Bulevardi**

Me vendim të ish-kreut të INUK Zyhdi Dajti janë pezulluar punimet që po kryente Bashkia e Tiranës për ndërtimin e bulevardit të ri të kryeqytet. Sot e kësaj dite këto punime vijojnë të jenë të bllokuara.

**Pallati**

Sërish me vendim të ish-kreut të INUK Zyhdi Dajti janë pezulluar punimet në ndërtimin e një pallati që po ndërtohej nga Gerti Çalliku dhe Xhuvni Sharxhi, të dy njerëz të afërm me Bashën.



Bulevardi i ri i bllokuar nga Zyhdi Dajti

LAJME shkurt

**Arrestohet polici, nuk raportoi kanabisin**

Një inspektor i policisë, i cili nuk raportonte për mbjelljen e lëndës narkotike kanabis në zonën që mbulonte ka rënë në pranga. I arrestuari është Osman Rexha, me detyrë ndihmës specialist i policisë së zonës në Komisaratin e Krujës dhe kishte nën varësi Fushë-Krujën dhe fshatrat përreth. Inspektori ishte nën hetim prej 3 muajsh, ndërsa dje SHÇBA ekzekutoi urdhrin e Prokurorisë së Krujës për masën e sigurisë "Arrest me burg" për Rexhën.



**Vlorë, pranga 60-vjeçarit, i çoi hashash të birit në burg**

Një 60-vjeçar nga Vlorë, gjatë takimit me djalin e tij në burgun e ri të qytetit i çoi atij 14.4 gram kanabis. Kadri Brami u arrestua në ambientet e burgut ku u zbulua se kishte fshehur në çorape lëndën narkotike. Djali i tij me inicialet E.B është i dënuar me 8 vjet burg për vjedhje në bashkëpunim. Edhe Kadri Brami ka kryer dënimin prej 1 viti për vjedhje. Policia thotë se lënda narkotike ishte e ndarë në 8 doza.

**Korçë, pranga 31-vjeçarit, në kërkim për trafik droge**

Gesti Pici, 31-vjeç, i shpallur në kërkim nga Gjykata e Krimeve të Rënda Tiranë, është ndaluar dje nga Specialistët e Seksionit kundër Narkotikëve të Korçës. Ndalimi i tij shtetasi është bërë pasi Gjykata e Krimeve të Rënda Tiranë, në datën 24 korrik 2015 ka caktuar masën e sigurisë arrest me burg për veprën trafikim të lëndëve narkotike. Materialet procedurale i kanë kaluar Gjykatës të Krimeve të Rënda Tiranë për veprime të mëtejshme.

# Ja biseda e përgjuar që futi në burg Zyhdi Dajtin

Si synohej të bllokohej pallati i miqve të Lulzim Bashës

ELTON QYNO  
TIRANË

Një bisedë telefonike e kryer mes dy inspektorëve të INUK, të cilët kishin marrë urdhër për pezullimin e punimeve të pallatit që po ndërtonin të afërmit e kreut të PD Lulzim Basha në rrugën e Elbasanit, ka shërbyer si indicie për marrjen të pandehur të ish-shefit të INUK Zyhdi Dajti dhe 14 vartësve të tij. Biseda e përgjuar është bërë mes punonjësve Ermal Kaçurit dhe një inspektori tjetër të cilët kanë folur lidhur me ndërtimet që po kryheshin në hapjen e gropës tek rruga e Elbasanit, ku po ndërtohej një pallat nga Gerti Çalliku dhe Xhuvni Sharxhi, ky i fundit bashkëortak me vjehrrin e Lulzim Bashës, Xhafer Isufi në ish-kompleksion "Jon" në Vlorë. Gazeta "Shqiptarja.com" zbardh sot të plotë bisedën e përgjuar nga prokuroria e Tiranës, pas së cilës u vendos arrestimi i Zyhdi Dajtit dhe personave të tjerë të INUK. Kjo pasi ata kanë marrë vendimin për pezullimin e punimeve, megjithëse gjykata Administrative e Tiranës, e kishte cilësuar disa ditë më parë si të paligjshëm vendimin, ata sërish vijonin me vendime të tjerë për pezullimin e punimeve.

**BISEDA E PËRGJUAR**

Transkriptuar me proces-verbalin e datës 10.07.2014, dhe konkretisht bisedat me interes të realizuar nga inspektori i INUK Ermal Kaçuri, i cili disponon numrin e telefonit celular 069 XXX404 me një kolegun e tij që disponon numrin 069XXX228, janë sa vijon:  
**INSPEKTORI:** E ke me urdhër me shkrim.  
**KAÇURI:** Mu mka thonë



Ish-kreu i INUK, Zyhdi Dajti



Biznesmeni Xhuvni Sharxhi

nejse, unë ke 16 katshi e kam shkrujt që s'ka aks e skedimit, ato i kanë sjellë 60 ditë bllokim, kurse ke ajo tjetra, ishte vendim gjykate mo vlla, mos t'hysh aty, vendim gjykate mos t'hysh aty, nejse ato s'ma kanë prezantu mu vendimin se...  
**INSPEKTORI:** Jo mo ti s'ke?  
**KAÇURI:** Po pavarësisht se unë e di që ata e kanë, nuk ma kanë goditur.  
**INSPEKTORI:** Se di çfarë thoshte Ban Laçi sot?  
**KAÇURI:** Ben Laçi, Ben Laçi i thotë Dita, ç'ke ti mer thotë, ç'ke mer ti, ç'ke mer ti, ik mer boje thotë, or ti zotni thashë unë sot nuk n'burg ti thash.....  
**INSPEKTORI:** Pse sot ee-ee.  
**KAÇURI:** Për çfarë o burri dheut, po pse a do merrshim i pallat, boji me vlla procedurat tamam, s'kualifiko lejet, boji gjithë procedurat se ti ke qëllim për me e shem.

**TE PANDEHUR**

- Agim Kaloci
- Albert Roshi
- Arben Laci dënuar
- Armand Bano
- Bledar Aliaj dënuar
- Bledi Isufi
- Dorjana Ferati
- Elvi Xhaxho
- Enkelejd Lamaj
- Ermal Kaçuri
- Ismail Kamberi
- Klara Mullaj
- Petrit Asllani
- Vilson Dushku
- Zyhdi Dajti

**INSPEKTORI:** Pse kishte fillu punë sot ai, pse kishte fillu punë sot ai?  
**KAÇURI:** Kush?  
**INSPEKTORI:** Te rruga e Elbasanit ee?  
**KAÇURI:** Ata, ata janë trem se subjekti m'duket, subjekti që do zbatojë projektin.  
**INSPEKTORI:** E he s'pranon me ndërtu.  
**KAÇURI:** Nuk ka qef, nuk ka qef me u përplas me qeverinë, më duket se ky është problemi.  
**INSPEKTORI:** E he.  
**KAÇURI:** Po nuk është problemi se ata do e fusin n'punë, ato tashi janë zi, zihen kto investitorët zihen me subjektin pse s'punon ti.  
**INSPEKTORI:** E he.  
**KAÇURI:** Për këto arsye zihen ato.  
**INSPEKTORI:** Po Beni çfarë thoshte sot ty?  
**KAÇURI:** Nuk folte fare, ik u zhduk o burri dheut, iku u zhduk.  
**INSPEKTORI:** Në drekë, në

**VIDEO / "KLANI" QË NDËRTOI "JON"-IN E BASHËS, KALLËZOI KREUN E INUK**




Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas

drekë që ju kërkoi?  
**KAÇURI:** Po i thashë or zotëri i thashë detyra shtetërore, përgjegjësia është private, është personale, do t'kërkoj ty llogari me emër, mbiemër, nuk t'kërko ty llogari si kryeinspektor, jo ne e bojmë e çojmë sipër, po ç'a t'çosh sipër ti më...".



**Miladini**

"E dini pse u prish bashkimi i Kongresit të Mukajt, ja sepse: n'atë kongres ishte shënuar fjala Shqipëri ethnike, domosdo për Kosovën. Miladini u nxi në fytyrë kur e mori vesh..."



Xhelal Staravecka

**DOKUMENTI I PLOTË**

Trakt' i I.

Xhelal Staravecka, një prej Komunistave të parë që filloi aksionet kundra italianëve, ikën prej Partisë sepse kjo ndodhet në duart e të huajve.

Po ribotojmë traktin që kryetari i një çete veterane partizane me shumë randësi, i mirnjoftuni Xhelal Staravecka ka shpërnda këto ditë në Jugë. Këtij trakti nuk duem t'i bajmë asnjë koment; themi vetëm se Shqipëria uron qi prej tij të marrin shembëll të gjithë komunistët me mënd në krye e me gjak shqiptari në deje. Qe trakti:

Shokë të inkuadruem në Partinë Komuniste të Dushanoviçit dhe Miladinoviçit, të dy Sërbër me sytë e tyre të zgurdulluar të kuq me gjak Shqiptarësh të pa fajshëm filluan të ngopin stomakun e tyre të urishëm sa na hodhë në këtë kataklizmë që nuk e ka parë historia Shqiptare.

Shokë! Partisë Komuniste neve të rinjtë i dhamë jetën dhe e rritëm, e forcuan si një diktatori të arsyeshme, mirë por ajo parti sapo e ndjejt vehten pak të fortë dillo diktaturën më të shëmtuar që të ringjethet mishtë.

Kujtoni shokë, të 65 (gjashtëdhjetepesë) katundarë të pafajshëm të marrë nga Hamit Matjani dhe nga Isa Manastirliu që nuk zbrazën pushkë kundra partizanëve por u dorëzuan, këta të shkretë u pushkatuan pa pikën e mëshirës prej Neronit Dushan Serbianit, Fiqret Sanxhaktari (Jovena e dytë e Napolit), Mehmet Shehut (Isa Toska i dytë) dhe gorillës Tahir Kadareja.

Shokë! Kujtoni viktimat e masakruara nga këta katër barbarë që therën me thikë e i hodhën të gjallë në zjarr banorët e Mallakastrës t'asaj Mallakastre që u bë gërmadhë nga reaksioni fashist... Ah! Sa mjerim, gërmadhat e Mallakastrës sot po vaditen me gjak të pafajshmish të atij populli nga duart katilë të Dushanit.

Shokë, e dini pse u prish bashkimi i Kongresit të Mukajt, ja sepse: n'atë kongres ishte shënuar fjala Shqipëri ethnike, domosdo për Kosovën. Miladini banorë të Metohisë, fushë e Kosovës, nuk durojnë që Kosova t'i hiqet Jugosllavisë. Për këto o

shokë u prish bashkimi i Mukajt, jam ndodhur vetë me shumë shokë të Qendrorit, në krye të cilvet ishte Druza Miladini, kur me një postë të jashtë zakonëshme arriti proklamata e Bashkimit të Mukajt. E hapëm proklamataën dhe e kënduam në fytyrën e lexuesit shndriti rrëzja e gëzimit për siahiriq të bashkimit, të gjithë u gëzuam. Më vonë e mira atë proklamata dhe duke i spjeguar gjysëm Shqip e gjysëm Sërbisht, pse unë nuk e di sërbsishten por edhe ai nuk e di Shqipen, por sido i varfër nga Sërbishtja i a spjegova dhe ai e kuptoi, në fytyrën e tij me një herë hipi një cergë e zezë dhe filloi të thotë: "nuk pranohet ky bashkim, neve tashti që po forcohem di të fillojmë nga spata e jo të bëjmë lidhje me qentë, pastaj Skipëri etniçka – jebentimajku –" neve që qemë tërë gas për bashkimin menjëherë fytyrat t'ona muarën ngjyrën serioze duke thënë: "Po këta pyzevënër nacionalistë do t'a shohin tashti sa të organizohemi dhe pak ditë se spatën do t'u vëmë, e sa e sa të thera duke thënë dashkan Shqipëri ethnike". Ju e kuptoni që fytyrat t'ona ndronin sipas asaj të Druzhës.

Në Berat vramë e premë pa hak për t'u marë paratë njerzve, Beratin e bëmë shtettrrethim që nuk e bëri as fashizmi; filluam e kontrolluam brekët e grave nëpër shtëpija, duke i rrethuar shtëpit' e Beratit me mitraloza; duallëm e bëmë çarmatimin e Nahijes, në katundin Perisneka zumë gratë nga sisët e nga shalët, e ku e di unë sa të tjera. Përpara këtyre poshtërsive që do t'i shihni në dokumenta, mora vendimin e largimit nga kjo Parti e Fëlliqur.

Sot ndodhemi shumë shokë dhe do të organizohemi në një parti koshite dhe jo rebele dhe nuk do të jenë lark ditë e shkallmimit prej themelit të Partisë gjakatore me Serbjanët gjakpirës e kriminelë në krye. JU O SHOKË SHPEJTONI TË LIDHEMI DORË MË DORË, RREHET E RRROTULLI SI KURORË. RROFTË BASHKIMI I POPULLIT SHQIPTAR!

POSHTË TERRORI DHE VËLLAVRASJA!

# XHELAL STARAVECKA.

## NË BERAT ME MITROLOZA NË DORË KONTROLLUAM DHE BREKËT E GRAVE

**TRAKTI NR.1/ Masakrat me Mugoshën në krye. Staravecka: "...Në katundin Perisneka zumë gratë nga sisët e nga shalët, e ku e di unë sa të tjera. Përpara këtyre poshtërsive, mora vendimin e largimit nga kjo Parti e Fëlliqur...**

ADMIRINA PEÇI  
TIRANË

**Trakt' i I.**

Xhelal Staravecka, një prej Komunistave të parë që filloi aksionet kundra italianëve, ikën prej Partisë sepse kjo ndodhet në duart e të huajve. Po ribotojmë traktin që kryetari i një çete veterane partizane me shumë randësi, i mirnjoftuni Xhelal Staravecka ka shpërnda këto ditë në Jugë. Këtij trakti nuk duem t'i bajmë asnjë koment; themi vetëm se Shqipëria uron qi prej tij të marrin shembëll të gjithë komunistët me mënd në krye e me gjak shqiptari në deje. Qe trakti:

Shokë të inkuadruem në Partinë Komuniste të Dushanoviçit dhe Miladinoviçit, të dy Sërbër me sytë e tyre të zgurdulluar të kuq me gjak Shqiptarësh të pa fajshëm filluan të ngopin stomakun e tyre të urishëm sa na hodhë në këtë kataklizmë që nuk e ka parë historia Shqiptare.

Shokë! Partisë Komuniste neve të rinjtë i dhamë jetën dhe e rritëm, e forcuan si një diktatori të arsyeshme, mirë por ajo parti sapo e ndjejt vehten pak të fortë dillo diktaturën më të shëmtuar që të ringjethet mishtë.

Kujtoni shokë, të 65 (gjashtëdhjetepesë) katundarë të pafajshëm të marrë nga Hamit Matjani dhe nga Isa Manastirliu që nuk zbrazën pushkë kundra partizanëve por u dorëzuan, këta të shkretë u pushkatuan pa pikën e mëshirës prej Neronit Dushan Serbianit, Fiqret Sanxhaktari (Jovena e dytë e Napolit), Mehmet Shehut (Isa Toska i dytë) dhe gorillës Tahir Kadareja.

Shokë! Kujtoni viktimat e masakruara nga këta katër barbarë që therën me thikë e i hodhën të gjallë në zjarr banorët e Mallakastrës t'asaj Mallakastre që u bë gërmadhë nga reaksioni fashist... Ah! Sa mjerim, gërmadhat e Mallakastrës sot po vaditen me gjak të pafajshmish të atij

as dezertimit të tij nga Ushtria Nacioni Çlirimtare, Xhelal Staravecka ndërmori një fushatë sulmesh ndaj udhëheqësve komunistë, të cilët sipas tij po e çonin vendin dhe popullin shqiptar drejt terrorit, dhe shkatërrimit të plotë. Në këtë fushatë ai botoi tetë trakte, të cilat cilat u botuan më vonë si një fashikull bashkë me një parathënie prej tij, botuar nga shtypshkronja "Atdheu". Ndërsa dje botuam traktin pesë, sot sjellim traktin me numwr 1, ku ai rrëfen vrasjen e 65 fshatarëve nga Mugosha, Mehmet Shehu dhe Fiqrete Sanxhaktari, ndërsa pak më poshtë në këtë trakt shënon se arsyeja e dështimit të marrëveshjes së Mukjes ishte se atje flitej për Shqipëri Etnike, e domosdo për Kosovën, çështje që Popoviç e Mugosha nuk donin as ta përmendnin. Më pas Staravecka tregon për terrorin dhe masakrat në Berat, ku siç thotë: "Në Berat vramë e premë pa hak për t'u marë paratë njerzve, Beratin e bëmë shtettrrethim që nuk e bëri as fashizmi; filluam e kontrolluam brekët e grave nëpër shtëpija, duke i rrethuar shtëpit' e Beratit me mitraloza; duallëm e bëmë çarmatimin e Nahijes, në katundin Perisneka zumë gratë nga sisët e nga shalët, e ku e di unë sa të tjera..."

Me poshtë e sjellim dokumentin të plotë.

# AKKP, zbardhen 5 mijë pronat e kthyera

## Emrat e pronarëve dhe pretenduesve në qytetin e Tiranës

**LORENÇ RABETA**  
TIRANË

Gazeta "Shqiptarja.com" vijon sot me publikimin e pjesës së gjashtë të listës me emrat e 700 pronarëve të cilëve u janë kthyer pronat e humbura nga

shpronësimi pas vitit 1945. Agjencia e Kthimit dhe Komensimit të Pronave ka zbardhur të gjitha vendimet e marra që nga viti 1993 duke krijuar një regjistër ku pasqyrohen në total më shumë se 43 mijë veprime me pasuritë e paluajtshme. Nga regjistri rezultojnë se në Tiranë janë marrë rreth 5 mijë vendime që u kanë njoh-

ur pronarëve të drejtën e kthimit të pronës. Në tabelë specifikohen emrat e subjekteve të shpronësuar, emrat e personave të cilët akant aplikuar për pronat. Për secilin subjekt është pasqyruar edhe pronat për të cilën i është njohur e drejta e kthimit nga ana e Agjencisë së Kthimit dhe Komensimit të Pronave: duke nisur nga

sipërfaqet trull apo tokë bujqësore, deri te shtëpitë apo dyqanet.

**REGJISTRI**

Në Regjistrin themeltar të vendimmarjes në kthim dhe komensimit të pronave janë pasqyruar të gjitha dosjet e depozituara në arkivë dhe protokollat e tyre; Qarku –rrethi

bashkia – komuna që këto dosje përfaqësojnë; Subjekti i shpronësuar dhe kërkuesit e autorizuar prej tyre për aplikim përpara institucionit të kthimit dhe komensimit të pronës; Sipërfaqet e pretenduara në rastin e dosjeve pa shqyrtim dhe sipërfaqet e kthyera dhe sipërfaqet e kompensuar në rastet e dosjeve me vendime.

### LISTA ME EMRAT E SUBJEKTEVE TË SHPRONËSUAR, TE PRETENDUESVE, DHE DYQANET, SHTEPITË E TROJET E KTHYERA

Emri Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri Mbiemri (Subjekti Kerkues)	Sipërfaqe e kthyer	Emri Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri Mbiemri (Subjekti Kerkues)	Sipërfaqe e kthyer	Emri Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri Mbiemri (Subjekti Kerkues)	Sipërfaqe e kthyer	Emri Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri Mbiemri (Subjekti Kerkues)	Sipërfaqe e kthyer	Emri Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri Mbiemri (Subjekti Kerkues)	Sipërfaqe e kthyer	Emri Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri Mbiemri (Subjekti Kerkues)	Sipërfaqe e kthyer	
Osman Koni	Batfjar Koni	2157 M2	Bajram Toçi	Baram Toçi	118 M2	Zenei (Kasem) Tafa	Kasem Tafa	1865 M2	Sherbet Buzi	Kalem Bushi	900 M2	Abdurrahman Mali	Adriatik Gashia	30000 M2	Sabri Zela	Bajram Kari	5000 M2	2332 M2
Hilmi Karapici	Gani Karapici	Shtëpi, Trull 500 M2	Ali Halebi	Badin Halebi	15 M2	Ramazan Lazi	Ramazan Lazi	10000 M2 (E Pa Qarte Ne Dispozitiv)	Kliethi, Pjera	Vasil Mineu	5000 M2 (Sipërfaqe E Pergjithshme 10000 M2= Tu Kthi) 852 M2	Shaqir Petrela	Hyshen Nalbani	14208 M2	Ibrahim Fijora	Hasan Ibrahim Dervishi	5780 M2	1105 M2
Abaz Shaba	Qemal Sufi	11 097 M2	Almet, Ibrahim, Xhafer Pinar	Trashëgimtarët Pinar	10000 M2 (E Pa Qarte)	Mehmet Hysa (Guri)	Haxhi Guri	3796 M2	Mustafa Keta	Buja Gjeçi	720 M2	Shaqir Petrela	Trashëgimtarët E Subjektit Shaqir Petrela	14078 M2	Sure Ajazi		825 M2	2000 M2 + 4650 M2
Muharrem Dorzi	Ali Dorzi	18 Ha	Ahmet, Ibrahim, Xhafer Pinar	Trashëgimtarët Pinar	1943 M2	Rexhep Hoxha	Rexhep Hoxha	88.7 M2	Vehibe Allituri	Xhela Barbulush	5000 M2	Shaqir Petrela	Redi Xhelepi	893.9 M2	Hysen Jegeni	Vesime Frasher	2000 M2 + 4650 M2	2000 M2 + 4650 M2
Shaqir, Alaman Mervepeza	Estref Mervepeza	8071 M2	Rexhep Spahiu	Rexhep Spahiu	88.7 M2	Rexhep Hoxha	Rexhep Hoxha	88.7 M2	Hysen Xhelepi	Zenepe Sela, Hajre Dejazi, Shashizam Dumullaku	2486 M2 Me Nerin 4	Shaqir Petrela	Shelqet Elezi	288342 M2	Sait Ymer Hoxha		763.54 M2	
Shyqiri Peza Avdi Kasalla	Ramiz Kasalla	6190 M2	Qazim Dani	Bixhan Dani (Hado)	412 M2	Daut, Ismail Mervepeza	Ismail Mervepeza	26258.4 M2 Trull	Hysen Xhelepi	Alush, Bajram Dede	720 M2	Shaqir Petrela	Eqerem Dede	3533 M2	Abdull, Mahmut Shikaku		6186 M2	
Nuredin Peza	Nuredin Peza	3088 M2	Malik Kullakshi	Ali Malik Kullakshi	2280 M2	Mahmut Hakrama	Mahmut Hakrama	12000 M2	Alush, Bajram Dede	Zenun Hoxha	16820 M2	Shaqir Petrela	Ramazan Dede	11663 M2	Ramazan Shima	Qerim Shima	11663 M2	
Qamili Karaj	Xheladin Karaj	27.3 Ha	Fari, Apostol Bukca	Apostol Bukca	25 M2	Xhafer Bej Stermasi	Muharrem Penalli	14150.5 M2	Alush, Bajram Dede	Zenun Hoxha	16820 M2	Shaqir Petrela	Arben Cemo	465 M2	Anil Cemo	Ismail Mehmet Hadari	21000 M2	
Ramazan Kodra	Ramazan Kodra	6 Ha	Jusuf Grebletshi	Agim Grebletshi	88 M2	Nezir Bej, Luftulla Stermasi	Nezir Stermasi	18250 M2	Alush, Bajram Dede	Shaban (Bajtar, Ismail, Abdulla) Bastari	5000 M2	Shaqir Petrela	Mahmut Patqou	2500 M2	Nezir E Luftulla Stermasi	Fatmir Çashku	13912 M2	
Avdi Kasalli	Ramiz Kasalli	154 200 M2	Xhemal Turku	Xhemal Turku	59 M2	Riza E Osman Elezi	Sure Tafa	3208 M2	Hysen Tatani	Sulejman Tafari	21500 M2	Shaqir Petrela	Haxhi Merxhani	25000 M2	Mahmut Patqou	Mehmet Patqou	1115 M2	
Sabrije Lici	Halim Jusufi	69.6 Dymym	Fehmi Tepelena	Fehmi Tepelena	410 M2	Hasan Beram Tafa	Sure Tafa	12700 M2	Haxhi Merxhani	Bashkim Merxhani	21500 M2	Shaqir Petrela	Pasko Pasko	1115 M2	Fatime Ypi Eji	Hektor Bregasi	62068 M2, 9500 M2	
Jonuz Nexhmi Shikaku	Luan Troksi	50 385 M2	Lin Gila	Lin Gila	422.5 M2	Xhafer Mançaku, Mustafa Mervepeza (Peza)	Mustafa Mervepeza	242 M2	Vasil Shkurti	Vasil Shkurti	470 M2	Shaqir Petrela	Osman Tegja (Dunshiti)	16200 M2	Fatime Ypi Eji	Hektor Bregasi	27052 M2	
Mahmut Jusufi	Zana Buzi	535 M2	Neki Radosvicka	Gezim Radosvicka	26757 M2	Besnik Meta	Besnik Meta	1054 M2	Osman Tegja (Dunshiti)	Faik Durishiti	1165 M2	Shaqir Petrela	Tahir Vadi	72.39 Dy	Fatime Ypi Eji	Hektor Bregasi	27052 M2	
Solir Kolesa	Zana Buzi	535 M2	Rexhep Ramolli	Rexhep Ramolli	110 M2	Haki Mancaku	Fiqiri Mansaku	12762 M2 (Neni 5), 12426 M2	Shaqir Lala	Ibrahim Lala	3000 M2	Shaqir Petrela	Shaqir Lala	3000 M2	Ibrahim Rexha	Shpetim Rexha	281.6 M2	
Muharrem Hula	Halim Jusufi	69.6 Dymym	Rexhep Ramolli	Rexhep Ramolli	110 M2	Haki Mancaku	Fiqiri Mansaku	12762 M2 (Neni 5), 12426 M2	Mexhit Kazu	Arben Kazu	3000 M2	Shaqir Petrela	Vasil Dino (Bollano)	342.79 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Yzeiri Cumani	Ismail Cumani	7200 M2	Nauber Selencica	Nauber Selencica	60 M2	Kasem Mançaku	Nuri Mansaku	1832 M2	Vasil Dino	Meri Dino	3000 M2	Shaqir Petrela	Nurije Kusi	168.5 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Haki Fani	Fatmir Fani	511 M2 I Mbolet	Myzejen Shaku	Sabaudin Grzardani	639.5 M2 Si Dhe 15.3 M2 E Zene Ngja Kjoske Sipas Neni 15	Kasem Mançaku	Nuri Mansaku	1832 M2	Vasil Dino	Meri Dino	3000 M2	Shaqir Petrela	Sulejman Lika	6000 M2	Jakup Deliu	Ramazan Deliu	2000 M2	
Xhemal Zela	Sherif Zela	11 872 M2	Tana Buda	Tana Buda	15325 M2	Sibe Mançaku	Hamdi Mezezi	2990 M2	Haki Veziri	Ejup Veziri	412 M2	Shaqir Petrela	Ibrahim, Isuf, Selim Riza Hysa	2406 M2	Hali Beshiri	Igji Pustina	66912 M2	
Sefer Sallaku	Shkelqim Salikim	3626 M2	Muharrem Xhat Boja	Kujtim Boja	5000 M2	Ismail Mançaku	Ismail Mançaku	6103 M2	Sulejman Bejtaga	Fiqer Ismaili-lati	240 M2	Shaqir Petrela	Abdulla Mezirin	6 D y	Hali Beshiri	Igji Pustina	66912 M2	
Alaman Toku	Shkelqim Spaho	1000 M2	Shahin Hamiti	Fadii Hamiti	16500 M2	Ismail Mançaku	Ismail Mançaku	6103 M2	Mustafa Ismaili-lati (Libohova)	Fiqer Ismaili-lati	240 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Haxhi Kika	Shkelqim Spaho	1000 M2	Ethem Copani	Nefre Copani	48 M2	Ismail Mançaku	Ismail Mançaku	6103 M2	Idriz Lika	Mustafa Lika	480 M2 + 80 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Jakup Deliu	Ramazan Deliu	10 450.5 M2	Ded Nikoli Miri	Gjovanni Miri	115 M2	Adem Mançaku	Sali Mançaku	30 Dy	Hamdi Guma	Jolko Guma, Alber Guma	Dyqan	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Hysen Locka	Petrit Locka	7000 M2	Vehip Hoxha	Neriman Hoxha	165 M2	Arif Allitsha	Mereme Allitsha	4400 M2	Abdulla Xhafa	Hane Xhafa	2016 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Mehmet Beshku	Sami Beshku	25 440 M2	Shaqir Kastroshi	Myrteza Gashita	4605 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Beqzat Beg	Beqzat Beg	790 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Shyqiri Copa	Evelina Cara	70 039 M2	Shaqir Kastroshi	Myrteza Gashita	3750 M2	Ymer Meta	Shyqiri Meta	2658 M2	Gani Arkaxhiu	Naxhije Arkaxhiu	750 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Sanie, Mynevere Haxhiallushi	Evelina Cara	70 039 M2	Shaqir Kastroshi	Myrteza Gashita	3750 M2	Ymer Meta	Shyqiri Meta	2658 M2	Hamdi Guma	Jolko Guma, Alber Guma	Dyqan	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Kisha Katolicke	Al Mariano Rasserini	2147.6 M2	Shaqir Kastroshi	Myrteza Gashita	3750 M2	Ymer Meta	Shyqiri Meta	2658 M2	Abdulla Xhafa	Hane Xhafa	2016 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Selim, Gjyle, Hysen Skenderi Makule Hula		18000 M2	Seva Shima	Durime Grapta	31 M2	Adem Mançaku	Sali Mançaku	30 Dy	Gani Arkaxhiu	Naxhije Arkaxhiu	750 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Qazim Kazazi	Qazim Kazazi	161.5 M2 Neni 12/769 Per Sipërfaqe 19.5 M2 Detyrim Riberje Apo Deraje	Haxhi Sina	Petrit Sina	7150 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Hamdi Guma	Jolko Guma, Alber Guma	Dyqan	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Selifxhe Meçe	Selifxhe Meçe	971 M2	Abaz Guzi	Besim Valleri	10 Ha Pyl	Ymer Meta	Shyqiri Meta	2658 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Abdulla Mara	Bujar Mara	141.9 M2	Hasan Musa Bastani	Rexhep Bastani	636 M2 Trull Ku Nodohet Ishi Meresa Qe Eshite Privatuar Nga Trashëgimtarët E Pronarit	Ymer Meta	Shyqiri Meta	2658 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Osman Pullazi	Osman Pullazi	309 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Zyhra Nikolica	Zyhra Nikolica	60 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Fatmir Peqa	Gezim Peqa	80 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Fatmir Peqa	Gezim Peqa	49 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Spase Mirce	Spase Mirce	229 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Sabrije Cali	Sabrije Cali	32 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Mahmut, Maliq Tafa	Maliq Tafa	3520 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Maliq Tafa	Maliq Tafa	640 M2 Neni 12/769 Per Sipërfaqe 19.5 M2 Detyrim Riberje Apo Deraje	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Haxhi Shima	Haxhi Shima	5 + 8.7 M2 Ti Kihehet Pronanti	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Elez Çoku	Elez Çoku	784 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Myrteza Shaban Katragjini	Muhamet Farka	Shtëpia Dhe Oborr 255 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Bajram Toçi	Bajram, Hatxhe Toçi	16.5 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Sadate Zhegu	Sadate Zhegu	784 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Neki Struga	Neki Struga	50.3 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Safie Linza	Safie Linza	140 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	
Abdulla, Ismail, Hali Skenderi	Abdulla Skenderi	Dyqan 13.6 M2	Metije Bastari	Nife Guzi	1.78 Ha	Adem (Abdi) Leci	Elmaz Leci	12 M2	Hamdi Xhixhabesi	Hatie Çaushti	1700 M2	Shaqir Petrela	Mynevere Haxhiallushi	11275 M2	Xhemal Bardhoshi	Gezim Kami	6000 M2	





Rubrika

## SHËNDETI

LEXIM I LEHTËSUAR

Për të ndihmuar njerëz në moshë të thyer rubrika "Shëndeti" botohet me gërmë më të madhe për të lehtësuar leximin



# Helmimi nga ushqimet ja si mund të mbroheni

**"Stomaku e ka të pamundur të pranojë një ushqim i cili është i skaduar apo ka baktere të shumta"**

**DRIÇIM ÇAKA**  
TIRANË

**N**grënia e ushqimeve disa orë pasi ato janë gatuar mund të sjellë dhe helmimin në këto temperatura të larta. Gjithashtu një tjetër shkak i helmimit është dhe konsumimi i ushqimeve të përgatitura apo të ngrira të skaduar. Shumë kompani në Shqipëri por dhe më gjerë, nuk janë të sakta me datën e skadencës ose i mashtrorjnë konsumatorët. Një rast i tillë është zbuluar dhe disa muaj më parë në qytetin e Fierit, ku pijet dhe ushqimet e skaduar u ndryshojnë data e skadencës. Por cilat janë simptomat që tregojnë se jeni helmuar nga ushqimi dhe duhet të shkoni në spital? Shenja e parë

është e vjella. Jo më shumë se pas 60 minutave, stomaku e ka të pamundur të pranojë një ushqim i cili është i skaduar apo ka baktere. Do të ndjeni dhe dhimbje në stomak apo shqetësime në kokë. Të gjitha këto raste tregojnë se keni ngrënë një ushqim i cili ka baktere. Në çdo rast nuk duhet ti besoni vetëm mënyrave tradicionale, por duhet të shkoni tek mjeku për të parë se sa është niveli i helmimit dhe nëse u është helmuar gjaku.

## HELMIMI

Nëse ushqimin e lini për më shumë se 2 orë në temperature 20-45 gradë, atëherë më shumë mundësi ai do të preket nga bakteret që sjellin helmim. Ushqime me lëng, mishi, mishi i pulës dhe mishi i derit, peshku, karkalecat, midhjet, djathi dhe orizi mund t'ju helmojnë nëse i lini për më



## KESHILLAT NË TEMPERATURAT E LARTA

- Vendosni ushqimet në frigorifer
- Lani enët përpara se të gatuar
- Ushqimet jo më shumë se 2 orë jashtë frigoriferit
- Kujdes me përdorimin e ilaçeve kur hani ushqim
- Kujdes me ushqimet që blini të ngrira
- Kontrolloni datat e skadencës
- Mos konsumoni ushqime që janë në prag të skadencës
- Kosi dhe djathi, preken më shpejt nga bakteret
- Produktet e detit në ambient normal, preket pas 30 minutash nga bakteret
- Ushqimi i gatuar nuk këshillohet të hahet menjëherë
- Ringrohni ushqimet në temperature 80 gradë
- Kur jeni sëmurë, përgatisni vet ushqimin
- Mos i përdorni enët për gatimin e disa gjellëve pa i larë ato

## KESHILLAT

### Ushqimet që duhet patur kujdes:

- Gjellët me lëng
- Mishi i pulës
- Mishi i derit
- Karkalecat
- Peshku
- Midhjet
- Djathi
- Orizi

shumë se 2 orë në ambient normal.

## ÇFARË DUHET TË BËNI?

Këshilla e parë që të mos helmoheni nga ushqimet është që pas gatimit, të vendosen në temperatura të freskëta. Këshillohet që pas 20 minutash, gjella të vendoset në frigorifer. Edhe ushqimet që blini të përgatitura apo ato që porositni duhet të vendosen në frigorifer pasi rrezikojnë të preken nga bakteret. Pasi të keni gatuar dhe ti keni vendosur ushqimet në frigorifer, këshillohet që ti konsumoni të ftohta, direkt nga frigoriferi, pasi nëse ngrihen në mikrovallë, ato mund të marrin baktere nga ambienti. Gjithashtu enët që gatuar duhet t'i lani me ujë të ngrohtë përpara se ti përdorni. Kujdesi më i madh duhet të tregohet me ushqimet e fëmijëve, pasi ata mund të helmohen shumë më shpejt se një i rritur.



## KËSHILLAT STUDIMET

### ◦ Sëmundjet

Një studim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka zbuluar se në temperatura shumë të lartë, trupi i njeriut nuk mund të preket nga disa sëmundje. Sipas studimit kjo vjen për shkak se temperaturat "vrasin" bakteret që janë në trupin tonë



### ◦ Brokoli

Brokoli është një nga perimet të cilat forcon kujtesën dhe rrit aftësinë e trurit për të reaguar shumë shpejt. Gjithashtu brokoli ndikon te përqendrimi, vëmendja dhe zvogëlon rrezikun e demencës, një sëmundje e trurit

### ◦ Mishi i pulës

Mishi i pulave të freskëta (kryesisht ato që rriten në fshat jo nëpër pulari), ndihmon personat që vuajnë nga diabeti. Mishi i pulës nuk përmban yndyrna dhe këshillohet të konsumohet sa më shpesh

**P**rindërit duhet të tregojnë një kujdes të veçantë për fëmijët pas moshës 3 vjeç. Sipas Institutit të Shëndetit Publik, duhet ti jepet një rëndësi e veçantë ushqimit, që nga mëngjesi deri në drekë. Këshillohet që në mëngjes ti jepni bukë, qumësht, djath, qumësht etj, sipas gramaturës së mëposhtme. Për drekë këshillohet mish pulë dhe fasule. Por ndërkohë që ISHP këshillon prindërit si të ushqejnë fëmijët një tjetër raport i Ministrisë së shëndetësisë tregon se kequshqyerja është në nivele shqetësuese. "Ndonëse rritja ekonomike në Shqipëri ka përmirësuar sigurimin e ushqimit dhe gjendjen e përgjithshme të ushqyerjes, kequshqyerja vazhdon të jetë e pranishme të fëmijët. Shkaqet e kequshqyerjes nga mikronutrientët në Shqipëri janë një kombinim i mospërshtatshëm të ushqimit në familje, praktikave jo të mira të ushqyerjes dhe kujdesit për foshnjën dhe fëmijën, si dhe aksesit i papërshtatshëm ndaj shërbimeve shëndetësore cilësore. Nga ana tjetër, mbipeshja dhe obeziteti si shfaqje të mbiushqyerjes, rritin ndjeshëm rrezikun e diabetit në moshën adulte. Nënushqyerja dhe mbiushqyerja kanë pasoja serioze të mbijetesës dhe zhvillimit të fëmijëve, gjendja e tyre shëndetësore në moshën adulte, si dhe te produktiviteti ekonomik i individëve, komuniteteve dhe kombeve", -thuhet në raport.

### RAPORTI DHE KËSHILLAT

Sipas raportit rreth 19% e fëmijëve nën pesë vjeç ishin të shkurtër për moshën, 5% ishin nën-peshë dhe 22% mbipeshë. Pamjaftueshmëria jodike është një prej shkaqeve më të parandalueshme të prapambetjes mendore të fëmijët, e cila mund të sjellë ulje prej 13.5 pikësh të koeficientit të inteligjencës dhe rezultate të dobëta në shkollë. Kjo pamjaftueshmëri korrigjohet lehtësisht duke përdorur kripë të jodizuara. Sipas një studimi të kryer nga Instituti i Shëndetit Publik, prevalenca e çrregullimeve nga pamjaftueshmëria jodike është ulur në shifrën 55% të fëmijët e moshës shkollore, krahasuar me shifrën 93% në vitin 1993 sipas një tjetër studimi të ISHP-së. Anemia është një problem i rëndësishëm në shëndet publik, pasojat e së cilës përfshijnë rritje të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë, prapambetje në rritje, rezultate të dobëta në shkollë, vonesa konjitive dhe apati. Te të rriturit, anemia shoqërohet me dobësi dhe lodhje, produktivitet të ulët, dhe rrit rrezikun e vdekshmërisë amtare nga hemorragjitë pas lindjes. Sipas këtij studimi, 17% e fëmijëve nga 6-59 muajsh kishin një nivel anemie, prej të cilëve 11% kishin anemi të lehtë (10.0-11.9 g/dl) dhe 6% kishin anemi të moderuar (7.0-9.9 g/dl) (ADHS, 2010). Praktikrat e papërshtatshme të ushqyerjes së foshnjës dhe fëmijës, duke përfshirë ushqyerjen nënoptimale me gj dhe ushqyerjen plotësuese, kontribuojnë në kequshqyerjen e fëmijëve dhe pamjaftueshmëritë e mikronutrientëve. Mossigurimi i ushqimit në familje luan rol në kequshqyerjen e fëmijëve shqiptarë.

# Këshillat

## Ja çfarë duhet të hanë fëmijët

### Këshillohet që në mëngjes t'i jepni bukë, qumësht, djath dhe mish



Cfarë duhet të dini



### Ushqimi

Për drekë këshillohet mish pulë dhe fasule. Ndërkohë që ISHP këshillon prindërit si të ushqejnë fëmijët një tjetër raport i Ministrisë së shëndetësisë tregon se kequshqyerja është në nivele shqetësuese



### Raporti

Praktikat e papërshtatshme të ushqyerjes së foshnjës dhe fëmijës, duke përfshirë ushqyerjen nënoptimale me gj dhe ushqyerjen plotësuese, kontribuojnë në kequshqyerjen e fëmijëve

### MENU 5 DITORE PER FEMIJET E GRUP MOSHES 3 - 6 VJEÇ NE KOPSHTE

Ditë e javës	Asortimentet Mëngjezi	Gramatura në gr.	Shtesa Ora 10.00	Kalorazhi në k.kal.	Asortimentet Drekë	Gramatura në gr.	Mesditë Zemër	Kalorazhi në k.kal.	Kalorazhi Gjithsej
E Hënë	-Bukë -Qumësht -Djathë -Gjalpë -Sheqer	50 200 30 5 5	1 Frut të stinës	120 100 75 +110F 120 19,7	-Bukë -Oriz pilaf -Fasule (me patate, karrota dhe qepë) -Mish viçi ose pule	25 200 200 80	Biskota me vezë	60 366 Z 204 257	1432
E Martë	-Bukë -Qumësht -Gjalpë -Reçel -Sheqer	50 200 10 20 5	1 Frut të stinës	120 100 240 +110F 57 19,7	-Bukë -Supë me oriz dhe zarzavate -Gjellë me zarzavate të stinës -Mish viçi ose pule	50 200 200 80	Kek	120 381 Z 116 219	1483
E Mërkurë	-Bukë -Qumësht -Çokokrem -Sheqer	50 200 20 5	1 Frut të stinës	120 100 110 +110 F 19,7	-Bukë -Supë me oriz dhe zarzavate -Pure patate -Mish viçi ose pule -Sallatë me zarzavate të stinës	50 200 200 80 110	Bukë me djathë dhe vezë -Bukë 50gr. -Vezë (1k.) -Djathë 30gr.	240 275 Z 124 316 72	1486
E Enjte	-Bukë -Qumësht -Gjalpë -Reçel -Sheqer	50 200 10 20 5	1 Frut të stinës	120 100 240 +110 F 57 19,7	-Bukë -Makarona me djathë -Gjellë me zarzavate të stinës -Mish viçi ose pule	25 230 200 80	Biskota me vezë	60 366 Z 377 230	1680
E Premte	-Bukë -Qumësht -Çokokrem -Sheqer	50 200 20 5	1 Frut të stinës	120 100 110 +110 F 19,7	-Bukë -Supë me oriz dhe zarzavate -Gjellë me patate -Mish.viçi ose pule -Sallatë me zarzavate të stinës	50 200 200 80 110	Bukë me djathë dhe vezë -Bukë 50gr. -Vezë (1k.) -Djathë 30gr.	240 275 Z 117 312 72	1475

Aleanca Atlantike, e mbledhur dje me urgjencë në Bruksel me kërkesë të Turqisë, dha një mbështetje të madhe për Ankaranë në ofensivën e saj të dyfishtë, kundër rebelëve kurdë dhe Shtetit Islamik. "NATO po i ndjek nga afër zhvillimet dhe ne garantojmë aleatin turk për solidaritetin tonë të fortë", deklaroi sekretari i përgjithshëm i NATO-s, norvegjezi Jens Stoltenberg, në hapjen e takimit të ambasadorëve të 28 vendeve anëtare të Aleancës. "Ky takim është i nevojshëm për t'u përgjigjur paqendrueshmërisë në portat e Turqisë dhe kufijtë e NATO-s", theksoi Stoltenberg, duke shtuar se terrorizmi në të gjitha format, në asnjë rast, nuk mund të tolerohet apo justifikohet. Ndërsa është dhënë një OK i fuqishëm për luftën anti-ISIS, NATO kërkoi që Turqia të mos braktisë bisedimet e paqes me kurdët.

**POLITIKA**  
Partnerja, deri tani vonë ngurruese, në koalicionin anti-ISIS, të udhëhequr nga Amerika, prej disa ditësh ka nisur të bombardojë pozicionet e Shtetit Islamik në vendin fqinj. Faktor në këtë ndryshim kursi të Ankarasë, sipas ekspertëve, ishin planet, ende të pashpallura zyrtarisht, për krijimin e një zone të pastër, pa praninë e militantëve të ISIS-it, përgjatë kufirit të saj me Sirinë, çka do të realizohet në bashkëpunim me Uashingtonin. Përveç shënjestrimit të xhihadistëve, kjo do t'i lejon-

**Kthesa**  
Qeveria turke e kishte mbyllur për një kohë të gjatë një sy përballë avancimit të Shtetit Islamik, madje i ka mbështetur xhihadistët që i kundërviheshin regjimit të Bashar al Assadit



Rexhep Taip Erdogan

**Kurdët**  
Kritikët ndaj qeverisë besojnë megjithatë se Turqia po i përdor sulmet ndaj ekstremistëve të ISIS vetëm si maskim për qëllimin e saj të vërtetë, që është goditja e një armiku të vjetër: kurdët

besojnë megjithatë se Turqia po i përdor sulmet ndaj ekstremistëve vetëm si maskim për qëllimin e saj të vërtetë, që është goditja e një armiku të vjetër: kurdët. Ngurrimi i Ankarasë për ta sulmuar më parë ISIS, sipas këtyre zërave, ishte në fakt ngurrim për të ndihmuar kurdët që luftonin kundër Shtetit Islamik dhe tani që mund t'i bombardojë të dyja palët, Turqia është e gatshme të përfshihet në betejë.

**QENDRIMI**  
Turqia nuk do të tërhiqet para kërcënimit terrorist dhe do të vazhdojë me vendosmëri luftën kundër grupit të Shtetit Islamik dhe kundër rebelëve të Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit (PKK), rikonfirmoi dje presidenti Rexhep Taip Erdogan. "Përjashtohet çdo mundësi për t'u tërhequr. Ky është një proces i gjatë dhe do të vazhdojë me të njëjtën vendosmëri", deklaroi Erdogan, ndërkohë që NATO u mblodh në Bruksel. Erdogan theksoi gjithashtu se ishte i pamundur vazhdimi i procesit të paqes me kurdët për aq kohë sa rebelët e PKK vazhdojnë të kryejnë sulme të përgjakshme kundër forcave turke të sigurisë.

**ATENTATI**  
Një shpërthim dëmtoi në mesnatë gazsjellësin që lidh Iranin me Turqinë në provincën kufitare të Agrit, në lindje të Turqisë, njoftoi ministria turke e Energjisë. Media turke ka akuzuar për këtë sabotim rebelët e Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit. PKK, nga ana e saj, ka shtuar operacionet e armatosura kundër forcave të sigurisë në juglindje të Turqisë.

# Terrorizmi, Turqia merr mbështetjen e NATO-s

## Perëndimi mirëpret luftën e Ankarasë anti-ISIS, "mos braktisni procesin e paqes me kurdët"

te Ankarasë edhe goditjen e pozicioneve të Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit. Në këndvështrimin e Turqisë, mes ISIS dhe PKK-së nuk ka ndonjë ndryshim të madh; që të dy këto grupe ajo i konsideron si organizata terroriste. Por dihet mirë nga të gjithë se luftëtarët kurdisianë janë duke luftuar me vendosmëri me militantët e ISIS në Siri e Irak. Nga ana



tjetër, qeveria turke e kishte mbyllur për një kohë të gjatë njërin sy përballë avancimit të Shtetit Islamik dhe, sipas disa raporteve, madje i ka mbështetur xhihadistët që i kundërviheshin regjimit të Bashar al Assadit.

Por një sërë veprimesh të militantëve, e sidomos sulmi kamikaz i Suruçit, e kanë nxitur më në fund Ankaranë të hidhet në aksion. Kritikët

### LAJME SHKURT



#### Putin: Blater i pafajshëm, ai meriton çmimin "Nobel"

Presidenti rus, Vladimir Putin ka folur për skandalin e korrupsionit të FIFA-s. Putin tha se ish presidenti i dorëhequr i FIFA-s, Blater nuk është "i përfshirë në korrupsion personalisht". Madje, presidenti rus ka vlerësuar maksimalisht edhe punën e Blater. "Unë mendoj se njerëz si z.Blatter, liderët e federatave sportive ndërkombëtare meritojnë një mirënjohje të veçantë", tha Putin gjatë një interviste për radiotelevizionin zvicerian RTS, dy ditë pas hedhjes së shortit për eleminatorët e botërorit të Rusisë. "Nëse dikush meriton çmimin Nobel këta njerëz janë kryesorët", shtoi ai.

#### Djali i ish-diktatorit libian, Mohamar Gadaf dënohet me vdekje

Siaf al Islam, djali i dytë i ish diktatorit libian, Mohamar Gadaf është dënuar me vdekje për krime lufte nga një gjykatë në Libi. Sipas portalit arab Al Arabya, djali i Gadafit nuk ishte i pranishëm gjatë procesit gjyqësor, pasi mbahet peng nga trupat rebelë në qytetin e Zintanit, 160 km larg Tripolit, por ai u njoh me akuzën me anë të një video konference. Siaf al Islam u ndalua nga trupat rebelë rreth një muaj pas kapjes së babit të tij në një shkretëtirë në jug të Libanit. Mbi të rëndon edhe një akuzë nga gjykata ndërkombëtare e Hagës për krime ndaj njerëzimit.

#### Dorëhiqet lordi britanik pas videos me kokainë e prostitutë

Anëtari Dhomës së Lordëve në Britaninë e Madhe, Lordi Sewel ka dhënë dorëheqjen pas filmimeve ku shfaqej duke konsumuar drogë në shoqërinë e dy prostitutave. "Kam njoftuar drejtuesit e Parlamentit për tërheqjen e anëtarësisë time në Dhomën e Lordëve. Çështja nëse me veprimet e mia kam shkelur Kodin e Sjelljes është e rëndësishme, por sidomos teknike. Besoj se përgjigjja më e mirë ndaj këtyre dy pyetjeve është se, unë mund t'i shërbej më mirë Dhomës duke e braktisur atë", ka thënë Sewel.



"Kërkoj falje për dhimbjen dhe turpin e shkaktuar", ka shtuar ai.



#### Pakistan, të paktën 69 të vdekur nga përmbytjet

Të paktën 69 viktima janë shënuar si pasojë e reshjeve të dendura të shiut gjatë ditëve të fundit në Pakistan, ndërsa shumë të tjerë janë shpallur të zhdukur. Sipas Autoritetit Kombëtar të Menaxhimit të Fatkeqësive, rreth 300 mijë persona kanë mbetur të pastrehë pas shkatërrimit të banesave. Shumica e viktimave janë nga provinca e Khyber Pakhtunkhwa, në veri perëndim të vendit. Rrugë, ura, dhe fushat e punuara në Khyber Pakhtunkhwa janë dëmtuar rëndë dhe më shumë se një e katërta nga një milion banorë janë shtuar vetëm në këtë zonë, bëri të ditur zyra humanitare e Bashkimit Evropian.

#### Operacionet, 1810 emigrantë të shpëtuar, 13 të vdekur



13 emigrantë u gjetën të vdekur në bordin e një barke, ndërsa më shumë se 1800 të tjerë u shpëtuan gjatë pesë operacioneve të realizuara në Mesdhe, në hapësirën detare me Italisë dhe Afrikës së Veriut. Lajmi është bërë i ditur dje nga një zëdhënës i rojave bregdetare italiane, i cili tha se shkaku i vdekjes së ende nuk dihet, ndërkohë që shtoi se viktimat u gjetën në bordin e një barke me 522 persona. Sipas vlerësimeve të Organizatës Ndërkombëtare për emigracionin, më shumë se 150 000 emigrantë kanë mbërritur në Evropë nëpërmjet detit që prej fillimit të vitit.

#### KE: Pretendimet e Varufaqisit, false dhe të pabaza

Komisioni Evropian i ka konsideruar "false dhe të pabaza" akuzat e ish-ministrit grek të Financave, Janis Varufaqis, i cili pat thënë se kreditorët e Greqisë kontrollojnë një pjesë të Ministrisë së Financave në Athinë. Zëdhënësja e Komisionit Evropian, Mina Andreeva, deklaroi dje se KE-ja dhe

FMN-ja "ofrojnë vetëm asistencë teknike në administrimin e taksave". Në mediat greke është përfolur së fundmi se ish ministri Varufaqis, kishte përgatitur plane sekrete për një sistem bankar paralel dhe rifutjen e monedhës dhrahmi në rast të daljes së Greqisë nga Eurozona.



## Bashkëpunëtor i Bajram Currit, Merlikës, Zogut e Hoxhës

Një fotografi e rrallë  
varrimi i Abaz KupitVdiq në vitin 1976 në SHBA, New York, trupi i tij  
prehet në Kew Gardens Cemetery në QueensBEQIR SINA  
NEW YORK

Në këtë fotografi që bëhet publike për herë të parë, duken Haxhi Nimani dhe veterani i legalitetit Musli Mulosmanaj, duke i bërë roje nderi para arkivolit me trupin e Heroit Abaz Kupi, mbuluar me flamurin kombëtar. Nderim, thotë Mulosmani, Kryetarit të përjetshëm të ish Organizatës Kombëtare Lëvizja e Legalitetit (OKLL) (sot Partia Lëvizja e Legalitetit, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës). I përjetshëm kujtimi i Tij. Abaz Kupi lindi në Krujë, më 6 gusht 1892, në një familje me origjinë nga Kurbin. Bashkëpunon me Esat pashtë Toptanin në 1914-n e bashkë me parinë e Krujës dalin kundër Lëvizjes së Shqipërisë së Mesme. Me formimin e qeverisë kombëtare të Lushnjës, së bashku me Bajram Curritin e Ahmet Zogun ai mori pjesë në luftën kundër malazezëve në Koplik. Merr pjesë në kryengritjet e M. Merlikës, B. Currit dhe Elez Isufit në shkurt-mars 1922. Më vonë u gradua major dhe shërbeu në Durres më 1934-n. Në ditët e agresionit fashist Italian, më 7 prill 1939, A. Kupi udhëhoqi qëndresën e repartit ushtarak të Durrësit dhe me pushtimin e Shqipërisë u largua në Stamboll, Turqi. Në vitin 1939 familja e tij e përbërë nga tre djemët Petriti, Rustemi e Fatbardhi, bashkë me nënën dhe motrat u internua në Himarë. Gjatë Luftës II Botërore, familja Kupi u dërgua në Itali dhe u mbajt në burgosur në burgun e Brindizit. Më pas i dërguan në një kamp internimi deri në vitin 1942 dhe më pas u lanë të lire. Abaz Kupi ishte një ndër organizatorët kryesorë të Konferencës së Pezës të mbajtur më 16 shtator 1942 dhe u zgjodh anëtar i KANÇ. Më 26 korrik 1943, ora 11.00 para dite, u mblodhën në shëpinë e dr. Ihsan Toptanit në katundin



Ceremonia e varrimit të Mustafa Merlikës në vitin 1968


Tapizë, Delegacioni i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe Delegacioni i organizatës "Balli Kombëtar". Me idenë e zgjerimit dhe të forcimit të frontit të përbashkët të luftës kundër italianëve, ai u bë nismëtar Konferencës së Mukjes, të mbajtur në datat 1-2 gusht 1943 për të arritur bashkëpunimin midis Frontit Nacional Çlirimtar dhe Ballit Kombëtar. Kur E. Hoxha hodhi poshtë Marrëveshjen e Mukjes me Konferencën e Labinotit në shtator 1943, Abaz Kupi u largua më 19 nëntor 1943 nga KANÇ. Më 21 nëntor formoi Lëvizjen e Legalitetit që synonte rikthimin e Mbretit Zog në Shqipëri. Pas kësaj udhëheqja e PKSH urdhëroi asgjësimin fizik të Abaz Kupit. Më 24 tetor 1944 Abaz Kupi u largua nga atdheu.

Familjen e la në Shkodër. Djali i vogël, Fatbardhi, u arrestua më 1945, ndërsa pjesa tjetër e familjes, bashkëshortja e tij dhe vajzat u internuan në Tepelenë e më pas në Myzeqe. Në emigration organizoi mërgimtarët për një bashkim politik, më pas u aktivizua në komitetin "Shqipëria e Lirë" me president Mit'hat bej Frashërin, që do zëvendësohej nga Hasan Dosti. Më 7 korrik 1949 u emërua president i Juntës ushtarake, nën projektin "Valuable" – organizim kontrollues i operacioneve ushtarake sekrete për destabilizimin e regjimit komunist në Shqipëri.

Më 1968 zhvendoset drejt Shteteve të Bashkuara. Vdiq në vitin 1976 në SHBA, New York, trupi i tij prehet në Kew Gardens Cemetery në Queens.

## Galeria Kombëtare e Arteve

## "Strategji dhe Taktika", një muaj në Tiranë ekspozitë e videoartit sllovak



Galeria Kombëtare e Arteve do të prezantojë nga 31 korriku deri në 30 gusht ekspozitën "Strategji dhe Taktika / Ekspozitë e videoartit sllovak". Ky prezantim vjen si rezultat i një bashkëpunimi mes Galerisë Kombëtare të Arteve dhe White House Biennial, një platformë artistike ndërkombëtare me bazë në Athinë, Greqi. Brenda kuadrit konceptual të edicionit actual, Sprova për Demokraci, White House Biennial do të prezantojë një program shumë-shtresësh ndërkombëtar të ndarë në dy ekspozita. Strategji dhe Taktika është ekspozita e parë e cila fokusohet në

videoartin bashkëkohor sllovak, kuruar nga Lýdia Pribišová. Në këtë ekspozitë do të marrin pjesë artistët artistët: Anton Čierny, Pavlína Fichta Čierna, Iva Durkáčová, Oto Hudec, Martin Kochan, Daniela Krajčová, Tamara Moyzes, Ilona Németh, Lucia Nimcová, Tomáš Rafa, Shlomi Yaffe, Anabela Žigová. Tema kryesore e ekspozitës, një përzgjedhje e videoartit bashkëkohor sllovak, është bazuar në kundërvënien mes strategjisë dhe taktikës. Dallimet mes tyre janë propozuar nga filozofi francez Michel de Certeau në librin e tij "Praktika e Jetën së Përditshme" (1984).

## AFORIZMA

Të dobëtit  
çdoherë e  
fillojnë të parët.  
FARELI

## Në fokusin e lexuesit online

## [SHQIPTARJA.com]

## LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Tiranë, sherr për vend parkimi pronari i hotelit i ngul çelësat policit
- Azilantët, Gjermania nis kthimin e refugjatëve nga Shqipëria
- Intervista/Aleku i Sadnës falenderon shqiptarët: Jeni të mrekullueshëm
- Britani, kapet me drogë shqiptar: Jam me mision nga Interpoli
- Vrasja në Itali, nëna e Memës: Daja nuk u vetëvra për Marjon
- "Molla e sherrit" Ilda Bejleri ndan nga Facebook-u një çift
- Xhensila e acaruar, reagon pas 'tradhëtisë' së Fatjonit në Turqi
- FOTO/ Fatjoni tradhëton Xhensilën me një ruse seksi, lidhja post BBB
- Prita në Rinas, grabitësit braktisin makinën, mbajnë 100 mijë eurot
- Blero 'hakmerret' ndaj ish-gruas së tij me rastin e 33-vjetorit të saj

## LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Ristani denoncon grabitjet në PD hajdutët 'hakmerren' me vilën e tij
- Ambasada e SHBA e ashpër: Turp që keni deputet të dënuar
- Qeveria nuk heq dorë nga "FBI" Braho: Gati Byroja e re e hetimit
- 'Ringjallet' Jezu Krishti, është australian dhe mbështetet nga...
- Rama: Eshhtë bërë batërdi paketë anti-krim për mjedisi

## VIDEOT MË TË KLIKUARA DJE

**Lu: E turpshme që deputetët shqiptarë janë dënuar për trafik**

**Pritë kambistit në Rinas, i grabisin makinën me 100.000 €**


**Tentoi të rregullonte rrjetën në ujë mbytet peshkatarit në Shkodër**

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas

## SONDAZHI IDITES

A besoni ju që z.Lulzim Basha do ja dorezoje personalisht detyren kryetarit te ri te bashkise z. Erion Veliaj?

## Rezultati i Sondazhit



## SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe ja kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



985 | 196.706  
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

# Skënderbeu fiton 2-0 ndaj Milsam në gusht kthimi

## Korçarët pranë historisë, një ndeshje pranë Europa League, siguron Playoff

**S**kuadra e Skënderbeut tashmë ka hedhur një hap historik duke qenë shumë pranë kualifikimit në grupet e Europa League. Kampionët shqiptar kanë mundur 2-0 skuadrën e Milsamin, ndeshje kjo e zhvilluar në Moldavi. Skënderbeu është i pari ekip që arrin kaq larg në këtë kompeticion por njëkohësisht duke patur tashmë pothuajse të sigurtë minimalisht pjesëmarrjen në fazën e grupeve të Europa League. Skënderbeu nuk kaloi në aventurë dhe në minutat e para ja la shumë iniciativën moldavëve, që të nxituri dhe nga publiku vendas u përpoqën të ishin të rrezikshëm përpara portës së Shehit. Në minutën e 14-të, Milsami provoi dhe një herë tjetër por pa rezultat. Ka qenë Berisha, që për Skënderbeun është bërë kërcënimi i parë për moldavët. Berisha sërisht në minutën e 21-të mori sërisht mirë krahu por nuk gjeti askënd në qendër që të

### KUALIFIKIMI



Nëse Skënderbeu kalon Milsamin dhe arrin të fitojë edhe takim për fazën "Play Off" të Ligës së Kampionëve, atëherë 'fluturon' në grupet e këtij kompeticioni. Nëse humbet në "Play Off" atëherë futet në Ligën e Europës.

devijonte topin drejt rrjetës. Pak sekonda më pas Berisha provoi zgjidhjen personale duke goditur pak mbi traversë. Milsami mori kon-

trollin e lojës por pa qenë asnjëherë shumë i rrezikshëm në portën e Shehit. Pjesa e parë u mbyll me rezultati 0-0 me një Skënderbeu shumë të balancuar në fushë. Në nisjen e pjesës së dytë Latifi nis një aksion në krahu e djathtë ndërsa jep një pas për Salihin, i cili dërgon topin në rrjetë duke kaluar në avantazh Korçarët. Shqiptarët vijuan presionin ndaj kundërshtarët ndërsa Lila në minutën 52-të humb një mundësi të artë. Do të duhej minuta e 72 kur korçarët fituan një penallti, e fituan nga Nimaga pas prekjes me dorë nga Monday. Sërisht është Hamdi Salihin, i cili e dërgon topin në rrjetë duke thelluar diferencën në 2-0. Pas përfundimit të 90 minutave, Skënderbeu bëhet e para skuadër pranë kualifikimit në grupe, ndërsa do ti duhet dhe ndeshja e kthimit për të forcur pozitën. Takimin e kthimit me Milsamin, Skënderbeu do ta luajë në Elbasan Arena me datë 5 Gusht.



Ndeshja Skënderbeu-Milsam

### NDESHJA

#### Shqipëri-Serbi, ndalohet hyrja për personat me precedentë penal



Cdo person që dëshiron të jetë prezent në stadiumin "Loro Boriçi" në Shkodër, gjatë ndeshjes Shqipëri-Serbi duhet ta blejë biletën me kartë identiteti apo pasaportë. Në të kundërt, biletat nuk do të shiten. Ky vendim është mësuar ditën e djeshme pas takimit të kryeministrit Rama, ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, kreut të FSHF, Armando Duka dhe Kryetarit të Shërbimit Informativ të Shtetit, Vislo Ajazi. Mësohet se kjo masë vjen për të shtuar sigurinë në stadium, në mënyrë që policia dhe autoritetet t'i kenë skeduar të gjithë tifozët dhe t'u ndalojnë hyrjen personave me precedentë penalë. Një tjetër arsye është edhe parandalimi i shitjeve të biletave në tregun e zi. Ndërkohë, në sfiidën për eliminoret e "EURO 2016" do të jetë edhe kryeministri serb, Aleksandër Vuçiq, i cili e ka konfirmuar pjesëmarrjen e tij edhe gjatë një interviste për "Suedische Zeitung".

### Deklarata

#### Mirel Joza: Kujdes nga euforia, na pret Elbasan Arena

Trajneri i korçarëve Mirel Josa ka kërkuar prej skuadrës të ruhet nga euforia e rezultatit duke kërkuar më shumë angazhim për ndeshjen e kthimit. "Na duket më shumë perfekte se fituam jashtë 2-0. Nuk pësuam dhe shumë dy herë. Thashë që loja e Milsamit do të luhet dhe 90 minuta të tjera. Për mua asgjë nuk ka mbaruar, dua të mbaj lojtarët me këmbë në tokë. Kam provuar rezultate të tilla dhe e di sa vështirësi kemi pasur me të tilla rezultate, në të kaluarën. Për ne është historike, dhe këtë duhet të mendojnë lojtarët tonë. Në mënyrë që të shkojmë më tej sa i përket kualifikimit të Europa League", tha Josa pas ndeshjes. Sipas tij Hamdi Salih i ishte heroi i kësaj ndeshje me dy golat e tij dhe për Josën shkodrani është një ndër ata lojtarë që flet me gjuhën e golit. "Salih është një lojtar që e ka treguar veten gjithmonë, kështu që nuk kam çfarë të shtoj unë për Salihin. Të gjithë i njohin vlerat e tij, edhe pse erdhi në një gjendje jo të mirë fizike aisi një profesionist i vërtetë arriti formën optimale në një kohë shumë të shkurtër dhe arriti të na ndihmonte me golat e tij", tha trajneri.

### LAJME SHKURT



#### Trajneri Murinjo: Hazard është më lart se Ronllo

Sipas Jose Mourinhos, sulmuesi i Chelsea, Eden Hazard duhet të merret në konsideratë si pjesë e tre futbollistëve më të mirë në botë, madje për momentin ai qëndron më lart edhe se Cristiano Ronaldo. "Vlerësimi për lojtarët varet nga sezoni që ata kanë pasur. Atyre ju duhet të fitojnë ndonjë titull apo jo? Messi pati triumfin e trefishtë, fitoi 3

kompeticione me Barcelonën dhe arriti në finalen e Kupës së Amerikës me Argjentinën. Nuk më pëlqejnë futbollistët që fitojnë trofe individuale, pa skuadrën. Për sa i përket karahasimit Hazard Ronaldo mendoj se futbollisti im pati një sezon më të mirë se Cristiano, pavarësisht se Ronaldo ishte fantastik duke shënuar shumë gola", tha ai.



#### Neymar: Nuk jam në garë për të kaluar Messin

Neymar nuk ka si objektivi të parakalojë Lionel Messin në hierarkinë e Barcelonës. Argjentinasi është pika e referimit në klubin katalanas, madje shumë analistë e konsiderojnë edhe si futbollistit më të mirë të historisë por kjo është një çështje që do të vazhdojë të krijojë polemika. "Nuk kam për qëllim t'i vendos vetes objektivin e parakalimit të Messit. Dua të vazhdoj në këtë rrugë hap pas hapi dhe t'i bëj gjërat në mënyrën e duhur. Objektivi im i momentit është fitorja e sa më shumë titujve me Barcelonën dhe Kombëtaren e Brazilit", tha ai.

#### Mishel Platini nis garën për kreun e FIFA

E përditëshmjia franceze L'Ekuipe shkruan se në ditët e ardhshme Michel Platini pritet të konfirmojë kandidaturën e tij për postin e presidentit të Fifa-s për zgjedhjet që do të mbahen shkurtin e ardhshëm. Ndërkohë presidenti aktual i

Uefa-s merr vlerësimin si njeriu më me influencë në botë në futboll, nga rrjeti prestigjioz amerikan ESPN. Sipas këtij studimi Michel Platini është de facto numri një në botën e futbollit si njeriu më ndikim më të madh në lojën më popullore në botë.



#### Ivan Gvozdenovic ndihmës trajner me Tiranën

Ivan Gvozdenovic ka nisur zyrtarisht punën me Tiranën si zëvendës-trajner për krahu Shkëlqim Muçës. 36-vjeçari, i cili ju bashkua të Hënën ekipit në Mavrovë nuk ka nguruar të nisë menjëherë detyrën e re, që shënon një rikthim për të të bardheblutë, jo si futbollist por si pjesë e stafit teknik. Vetë Gvozdenovic është shprehur i lumtur që ka firmosur me një klub shumë të madh në Shqipëri duke shpalosur dëshirën që gjatë këtij viti të kontribuojë për fitimin e titullit të 25-të nga ana e kryeqytetasve.

#### Leonardo Bonucci nis zyrtarisht me Juventusin

Leonardo Bonucci ka nisur angazhimin e tij në skuadrën e Juventusit. Në ambientet e Juventus Stadium në prani edhe të presidentit Andrea Agnelli mbrojtësi 28-vjeçar hodhi firmën mbi kontratën e re që do ta lidhë me bardhezinjtë deri në vitin 2020. Rinovimi i Bonucci ishte i 4-ti në radhë pas atyre të Buffon, Chiellini dhe Marchisio. Qëndërmbrojtësi italian tashmë konsiderohet një flamur i Juventusit. Bonucci në fjalën e tij nënvizoi faktin se këtë sezon për bardhezinjtë do të nisë një cikël i ri.



#### Vidal nis aventurën me Bayern Munich

Nis zyrtarisht aventura e Arturo Vidal me Bayern Munich. 28-vjeçari fillimisht kaloi me sukses vizitat mjekësore ndërsa më pas mesfushori kilian, kartoni i të cilit i kushtoi bavarezëve rreth 40 milionë Euro pasi firmosi kontratën që do ta lidhë me kampionët e Gjermanisë për 4 vitet e ardhshme foli për herë të parë si një lojtar i Bayernit. 28-vjeçari për kanalin tematik të klubit u shpreh shumë i lumtur që është bërë pjesë e një klubi të madh si Bayerni ndërkohë që theksoi se transferimi të bavarezët është një hap i madh përpara në karrierën e tij.



PARADË FJALËKRYQESH

NGA Kadri VOKOPOLA



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 34 KUTI

12x17 grid for word search puzzle.

HORIZONTAL


- 1. Ishiti kalorës të Karlit të madh. -Njicalet e Stone regjisor. -Një pjesë e mekanikës. 2. Janë kolegët e Rexhep Qosës. -Shkëlqim, aktor. 3. Një sherr në shtyp. -U interpretua nga Charlton Heston. 4. Eshhtë e përpjeta. -Janë certifikatat. 5. Në krye të masave. -Gjysmë aneksi. -Taraskonës ai i Daudet. 6. Teke prite. -Eshhtë spektakël pa zë. 7. Lou që qe rockstar. -Eshhtë e parë për prodhim. -Opera e Mascagni-t. 8. Ishin Posidoni dhe Eoli -Finte pa zanore -Ente Publike Tiranë. 9. Kufizojnë një truk. -I dha Ulishtë Palladin. -Fillojnë reformat. 10. Një shok në shoqëri. -Një pjesë e amerikanëve. -Një thëllim. -Ruhet në fund. 11. Një vend si Norvegjia. -Qytet në fillim garën. 12. Janë edhe ato të Bashkuara Arabe.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

Word search grid with words highlighted in black.

- Fund filmi. -Ka ngritur krye një i tillë. VERTIKAL 1. Pak papastërti. -Kështu është një emision që s'mbaron kurrë. 2. Ende ndryshe -E ka simbolin Cr një i tillë. 3. Një Altin ish-mesfushor. -Guardiola trainer. -Një numër ju për meshkuj. 4. Qytet në Australi. -Adresë e shkurtër. 5. Janë djajtë. -Eshhtë pije e jona. 6. Eshhtë njeriu pozitiv. -Lejon me një jo -Kufizojnë katete. 7. Qe perëndesha e fitores. -Parashtesë për pesë. 8. Ente Kërkomere Elbasan. -Një biçikletë dyshje. 9. Krijoi Philo Vance. 10. Topi që goditi Liezhin. -Ekstremitë stadium. 11... conte di San Bonifacio në një opera të Verdi-t -Mund të jetë domenikan. 12. Qytet në Kaliforni. 13. Mita që qe aktor. -Gjysmë arrest. 14. Të shushat. -Kërkojnë talent të tilla. 15. Janë detarët. -Emma Bunton. 16. Fillojnë mirë. -Mund të jetë urdhri 17. Një qenush. -Një ekspert i të bukurës.

FJALËKRYQI SPORTIV



PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

Sports crossword grid with words filled in.

HORIZONTAL

- 1. Mbyllin një takim. 5. Kush nuk ka... nuk i ecën. 8. Pak diletantizëm. 10. Eshhtë imadhi ndërmjet skuadrave në një derby. 15. Ishite Teuta kur ishte në... binarë. 17. Diftong në dietë. 18. Janë armë precizioni. 19. Klub Sportiv. 22. Janë gjërat e mërzitshme. 23. Villa në kampionatin anglez. 26. Emri i Tyson. 28. Hetim pa kurrij. 30. Dybala te Juventus.

- 31. Sastre aktore. 32. Nisin nga kreu. 33. Eshhtë lojtari i under 21. 34. Fillojnë romanin. 35. Mbyllin portet. 38. Personazhi në foto. 45. Personazhi në foto.

VERTIKAL

- 1. Në krye të idealistëve. 2. Një derby i "Madonnina-s". 3. Qytet në Itali. 4. Tyler aktore. 5. Santa në Neë Mexico. 6. Eshhtë baba. 7. Me break në tenis. 9. I paharruari Borçji. 10. Eshhtë autormë. 11. Me mirë se kurrë. 12. Ai dhe ajo 13. Pak literaturë 14. Eshhtë detyrim që paguhet. 16. Einslet aktore. 18. Një sigil që tremb boksierin. 20. Një pjesë e studimeve 21. Zorr, ish-portier i famshëm. 22. Një qender. 23. Fajin pa kurrij. 24. Mbyllin një simbol. 25. Në krye të notarëve. 26. Josa trainer. 27. Kufizojnë katete. 29. Fundi një filmi. 35. Ente Grumbullimi Durrës. 36. Një alien. 37. Emri i dikurshëm i Tokyos. 39. Në mes të dhomës. 40. Fund janari. 41. Janë në degë. 42. Ruhet në fund. 43. Roberti Zemeckis. 44. Kufizojnë elemente

SUDOKU

PLOTESONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1-9

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

HOROSKOPI

DASHI

Dite mjaft e qete kjo e sotnja për ata qe janë në një lidhje. Do i shihni gjerat me një sy tjetër dhe gjithçka ka për t'u ecur për mirëkulli. Beqaret do realizojnë taktike pa fund, por asnjeri nga personat nuk do ua mbushë aq shumë mendjen sa për të filluar një lidhje. Gjendja e financave do vazhdojë të mbetet e mirë. Do dini sa para të shpenzoni dhe sa të hiqni mënjani.

DEMI

Pozicionimi i Marsit do jete i mire në jetën tuaj në çift. Do merreni vesh për çdo gjë me personin qe keni në krah dhe do i harroni problemet e se sikurës. Beqaret do bien në dashuri me një person me të vogël në moshe, por me një shpirt luftarak dhe tejet të matur. Për të përmirësuar financat duhet të përfitonni nga çdo mundësi qe do i jepet. Bëjini sytë katër.

BINJAKËT

Do jeni të parrezistueshem sot ju te dashuruarit dhe do dashuroheni si te çmendur me njeri-tjetrin. Çdo moment do jete fantastik dhe do përjetoni emocione dhe kënaqësi pa fund. Beqaret nuk do jene në humorin e duhur dhe do i refuzojnë ftesat qe do ju bëhen. Gjendja e financave do jete tejet e trazuar. Nuk do arriini dot të kryeni as shpenzimet me te nevojshme.

GAFORRJA

Dite e zakonshme dhe pa probleme kjo e sotnja për ata qe janë në një lidhje. Do ndiheni me se mirë në krahet e partnerit tuaj dhe emocionet do jene te njëpasnjëshme. Beqaret nuk do jene me fat në dashuri dhe nuk do e ndryshojnë dot statusin e tyre. Ne planin financiar mos kryeni shpenzime te konsiderueshme sepse gjendja mund të përkëqesohet menjëherë.

LUANI

Marrëdhënia me partnerin do jete goxha e ngrohte gjate kësaj dite. Do qëndroni me shume kohe me te dhe do flisni për çdo lloj gjeje pa pasur problem aspak. Beqaret do vazhdojnë të mbeten vetëm sepse mundësitë qe do iu jepen nuk do jene aq te mira sa ata kanë ëndërruar. Ne planin financiar do gjeni me në fund një zgjidhje për te dale nga situata e ndërlikuar.

VRGJËRESHA

Dite shume e turbullt do jete kjo e sotnja për ata qe janë në një lidhje. Nuk do merreni vesh për asgjë me partnerin dhe problemet do jene te njëpasnjëshme. Beqaret do njihen me persona interesante te cilët do i bëjnë te ndihen mire. Ne planin financiar fati do jete ne anën tuaj. Gjendja do jete aq e mire saqë do arriini t'i shlyeni te gjitha borxhet.

PESHORJA

Do keni mosmarrëveshje te mëdha sot ju qe jeni në një lidhje dhe për asnjë çast nuk do jeni te qete. Te dy do bëni gabime dhe asnjeri nuk do e ule hundën. Beqaret nuk do e ndryshojnë dot statusin gjate kësaj dite, por miqtë nuk do i lënë për asnjë çast të mërziten. Ne planin financiar gjendja do jete e trazuar. Mos kryeni ne asnjë mënyrë shpenzime te tejkajshme.

AKREPI

Dite aspak e mire kjo e sotnja për ata qe janë në një lidhje. Do ndiheni here pas here keq dhe nuk do dini nga t'ia mban. Beqaret duhet te presin edhe disa kohe nëse duan te kenë në krah një person me vlera dhe qe te dije t'i respektoje. Ne planin financiar mos kryeni investime te tejkajshme sepse gjendja nuk është e favorshme aspak. Prisiñ edhe disa kohe për këtë gjë.

SHIGJETARI

Do jeni te vendosur t'i zgjidhni një e nga një te gjitha problemet gjate kësaj dite ju te dashuruarit dhe e ardhmja ka për te qene me e qete. Beqaret do mundohen gjate gjithë kohës ta gjejnë personin e duhur, por mundimi do ju ike me kot. Te ardhurat do vijnë dalëngadalë duke u përmirësuar. Do i bëni mire llogaritë para se te kryeni çdo shpenzim.

BRICJAPI

Çastet e lumtura do jene te shumta sot për ju qe jeni në një lidhje. Shfrytëzojeni sa te mundni çdo sekonde dhe keni për te përjetuar ndjenjë të forta. Beqaret do jene në sjaër dhe nuk do përfitojnë nga ftesat qe do ju bëhen. Do pendohen shpejt, por do jete tepër vone. Financat do i menaxhoni me kujdes gjithë kohës dhe gjendja do mbetet e mire.

UJORI

Do dashuroheni pa dorashka sot juve qe jeni në një lidhje dhe do filloni ta shihni me një sy tjetër te ardhmen. Partneri do ju përgatisë edhe surpriza. Beqaret do reflektojnë gjere e gjate sot për atë qe duan te bëjnë dhe me pas do fillojnë te joshin personat qe do ju pëlqejnë Financat do i stabilizojn me shpejt nga sa keni menduar fale një shpërblimi qe do merrni në pune.

PESHQIT

Ambienti yjor do jete tejet i favorshëm sot për jetën tuaj në çift. Do pajtohemi me partnerin dhe e ardhmja ka për te qene shume here me ndryshe. Beqaret do kenë një dite te zakonshme dhe pa donjëzë takim mbresëlënës. Duhet ende te presin për te bërë ndryshime. Me shpenzimet tregohuni sa me te rezervuar sepse në çdo moment situata mund t'iu dale jashtë kontrollit.

PËRGJIGJE

Small crossword grid with words filled in.

SHKRONJA E NJËTË PËR NUMËR TË NJËTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

Large crossword grid for cryptogram puzzle.



Emisioni Tête à Tête moderohet nga gazetari i mirënjohur

**ARTUR NURA**

dhe ndiqni çdo të **hënë**, të **mërkurë**  
dhe të **premtë** në orën **18:10- 19:55** në **TV**

**A1 REPORT!**

**Ritrasmentim:** Të martën 00:30  
Të mërkurë, të premtë 23:30



**Të ftuarit e Tête à Tête vijnë nga fusha e politikës, shoqërisë civile, feve, shkencës dhe arteve të bukura ku ata/ato që sjellin në vëmendjen publike qasjet e tyre specifike kryesisht për temat më të ndjeshme për publikun**

*Në fokus të këtij emisioni vijnë herë pas herë edhe individë të cilët kanë/janë zë i veçantë në fushat e tyre si mjekë, stilistë, inxhinierë apo edhe biznesmenë të suksesshëm*